



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional

“Politika Publike”

i

Institucionit të Arsimit të Lartë

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës - UAMD

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Islam Jusufi


2. Dr. Klejdi Kellici

Dhjetor/2020

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Për Programin e studimit: Master Profesional në “Politika Publike”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Administrim Publik
3	Emërtimi i programit të studimit:	Politka Publike
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 633, datë 05.10.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Program i ri, regjistrohet pas akreditimit
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit
10	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	10/2
18	Numri i studentëve:	24
19	Komente / të tjera:	-



2



PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM TE PROGRAMIT

UAMD dhe specifikisht DAP ofrojnë programe studimi në fushën e Administrimit Publik. Masteri në Profesional në Politika Publike është një prej programeve të pakta në këtë fushë dedikuar studimit të politikave publike. Kurrikula fokusohet nëprobleme të ndryshme të përgjithshme e specifike të Politikave Publike në nivel teorik dhe praktik. Ky master është ofruar për herë të parë në vitin 2018. Qëllimi i tij është të përgatisë figura profesionale të afta të punojnë në menaxhimin e politikave publike, në sektorin e Administratës Publike. Po kështu ai synon të formojë dhe figura profesionale të afta të punojnë dhe në sektorin privat e që mund të realizojnë lidhjen mes këtij të fundit dhe sektorit publik. Më specifikisht figurat profesionale që synohen të formohen jnaë ato të funksionarëve publikë, ekspertëve të vlerësimit në fushën e politikave publike, konsulentë e të tjerë.

Masteri ka 60 ETSC. Lëndët të cilat ofrohen mbulojnë disa fusha si ato të menaxhimit publik, të drejtës publike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare. Njohuritë janë të balancuara në mënyrë që të arrihen sa më mirë qëllimet e programit. Në fund të tij studentët kryejnë dhe një praktikë në institucionet që kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me DAP dhe UAMD. Këto marrëveshje janë nënshkruar me insititucione publike kryesisht, locale dhe kombëtare. Përmes këtij programi DAP synon të japë një kontribut sa lokal aq edhe kombëtar në fushën e Politikave Publike.

Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm; 200 fjalë

Vlerësimi është përgjithësisht pozitiv me pak nota kritike, mundësitë për përmirësimin e të cilave UAMD e ka. Gjatë vizitës dhe vlerësimit u vu re një disponibilitet i madh nga strukturat akademike dhe burokratike për ti vënë në dispozicion komisionit vlerësues të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për vlerësimin e programit MPPP. Me gjithë shtrëngimet e krijuara nga situata dhe emergjenca Covid 19, anëtarët dhe zyrtarët e departamentit bënë një prezantim të kënaqshëm të programit dhe mendojmë se kanë përmbushuar plotësisht kërkesat dhe detyrimet që rrjedhin nga procesi i akreditimit. Gjithsesi gjatë këtij procesi u vunë re disa probleme të cilat janë përmbledhur në analizën e pikave të dobëta të Univesitetit. Këto kanë të bëjnë me mungesën e regjistrave për MPPP, mungesën e autonomisë së pedagogëve në procesin e vlerësimit të studentëve dhe hapësirën e kufizuar të ambienteve që i dedikohen specifikisht studimit të studentëve.



4

Në vijim të komenteve të marra nga UAMD për programin e studimit të ciklit të dytë Master Profesional “Politika Publike”, ju njoftojmë se morëm dijeni mbi materialin dhe më poshtë shprehim mendimin tonë mbi të:

Komenti 1

Standarti III. 9, Kriteri 2

I qëndrojmë plotësisht vlerësimit të dhënës sikurse del dhe nga minutat e takimit të zhvilluar në praninë e ekspertëve, të trupës akademike, zyrtarëve të UAMD, DAP dhe studentëve, datë 5 tetor 2020.

Komenti 2

Standarti III. 9, Kriteri 4

I qëndrojmë plotësisht vlerësimit të dhënës sikurse del dhe nga minutat e takimit të zhvilluar në praninë e ekspertëve, të trupës akademike, zyrtarëve të UAMD, DAP dhe studentëve, datë 5 tetor 2020.

Komenti 3

Standarti III. 9, Kriteri 9

Mbi sa më sipër u morën parasysh komentet sqaruese të UAMD, DAP mbi çështjen e vënies në dispozicion të dokumentacionit, studentëve, pas mbarimit të studimeve. Këto ndryshime do të reflektohen në RVJ në kategorinë dhe kriterin përkatës.

Komenti 4

Standarti IV,5, Kriteri 1

Në raport janë reflektuar më shumë argumentat mbi të cilat ky kriter është vlerësuar. Ndryshimi është bërë mbi këtë vlerësim.

Komenti 4

Standarti V,5, Kriteri 1

Në raport janë reflektuar më shumë argumentat mbi të cilat ky kriter është vlerësuar. Vlerësimi nga ana jonë nuk ka ndryshuar por janë shtuar dhe referencat mbi të cilat ky argument është mbështetur sikurse janë: Ref. RVB, fq. 46; Aneks 2 – Dok. Rregullore UAMD; Aneks 19 – Dok. Rregullore FSHPJ; Aneks 23 – Dok. Rregullore e programit MPPP; Aneks 47 – Dok. Procedure Diplomimi DAP; Aneks 68 – Dok. paketa e udhëzimeve e praktikës dhe mikrotezëz shembull; Aneks 107 – Dok. Syllabuse MPPP 2019 - 2020; Takimi me stafin akademik.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional “Politika Publike”


I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Standardi I.1				
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	MPPP ka për qëllim të formojë rishtas ose ti ofrojë formim kryesisht anëtarëve të administratës publike në Shqipëri. Ai nuk bie ndesh me interesat kombëtare.			
Kriteri 2 Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit ofrohet nga një prej departamenteve më të vjetër të UAMD, e që ka shërbyer si shtysë për formimin e vetë Fakultetit të Shkencave Politiko-Juridike në këtë universitet.			
Kriteri 3 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Misioni i institucionit është ai i ofrimit të arsimit si e mirë publike duke listuar më pas një sërë objektivash sociale e politike si përgatitja e shencëtarëve të rinj apo të zhvilluarit e mendimit kritik e analitik (shih Aneksin 1 Statuti UAMD).			
Kriteri 4 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Qëllimi i Universitetit është të ofrojë formim për specialistë të rinj për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. (shih Aneksin 1 Statuti UAMD)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Universiteti ka një plan strategjik zhvillimi për periudhën 2016-20. Ky plan përmban tre shtylla a-cilësinë dhe ekselencën e studentëve b-ekselencën në mësidhënie dhe kërkim shkencor c-ndërkombëtarizimin me projekte dhe shkëmbime me institute simotra (shih Plani Strategjik i Zhvillimit të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, Aneksi 6). Për këtë UAMD përcakton si esenciale ofrimin e programeve të përshtatshme për nevojat e tregut të punës.
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen	Drejtimit prioritar të statutit përsëriten në atë të Njësisë kryesore dhe atë të njësisë bazë. Qëllimi i UAMD është arritja e ekselencës në mësidhënie e posaçërisht program në fjalë është ndofta i vetmi i ofruar në territorin shqiptar apo ndërkombëtarizimi. Si prioritet ndërkombëtarizimi nuk ka si qëllim vetëm lidhjen e subjektit me

në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	subjekte simotra por shërben dhe për diversifikimin e ofertës akademike dhe rritjen e cilësisë akademike. Si shëmbull për këtë mund të citojmë marrëveshjen që UAMD ka nënshkruar me Universitetin e Nicës Sophia Antipolis për një program të dyfishtë në fushën e administrimit publik.			
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.	Masteri në Politika Profesional në Politika Publike ofrohet në përputhje me fushat akademike të Institucionit, Njësisë Kryesore dhe asaj bazë. Kjo del në pah dhe nga Plani Strategjik i FShPJ 2019-21, brënda të cilit gjendet dhe plani strategjik i DAP, po përkëtë peridhë (shih Aneksin 10 dhe 11)			
Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.	MPPP është ndërtuar duke patur parasysh disa kriteret: a- plotësimin e ofertës akademike të DAP b- përvojën/formimin e stafit akademik. c- nevojën për formim të mëtejshëm të anëtarëve të administratës publike d- tregun e punës			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programet e studimit “Master profesional” synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit “Master profesional” kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.	Objektivat e masterit janë: a-përgatitja e specialistëve të politikave publike b-specialistëve të administratës publike c-përgatitja për studime të thelluara doktorale. Këto objektiva duhet të jenë më të qartë. Duket sikur ka një mbivendosje mes figurave profesionale që MPPP ka me programin sivëlla të Adminstrimit Publik. (Aneksi 23).
Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe	Studimi i tregut të punës nuk parashikon një analizë të asaj çka ndodh me studentët që mbarojnë studimet, nëse, kur dhe ku ato punësohen. Më së shumti analiza ofron pikëpamjet e zyrtarëve të administratës publike si dhe pritshmëritë e studentëve (Aneksi 73) Ndonëse Universiteti promovon dhe faciliton organizatën Alumni, ai nuk e shfrytëzon këtë për të bërë një analizë të sektorëve ku punësohen studentët e UAMD (për shoqatën Alumni shih Aneksin 51)





zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.									
Kriteri 3. Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.	Struktura e MPPP ofron dijet e mjaftueshme për tu integruar në tregun e punës. Ky treg gjithësi është fiks e deri diku inert për vetë kapacitetet e Administratës Publike për të punësuar të gjithë të diplomuarit nga ky program. Në njërin anë kjo i jep mundësi programit të konsolidohet në kohë, si nga pikëpamja e tërësisë si nga ajo përmbajtësore e çdo lënde.								
Kriteri 4. Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.	Programi është ndërtuar në bazë të praktikave më të mira ndërkombëtare, programeve të ngjashme dhe nevojave të brendshme të institucionit dhe tregut të punës. Lëndët janë lehtësisht të konvertueshme në ETSC gjë që e bën të mundur mobilitetin dhe pse për një program një vjeçar si masteri profesional, mobiliteti është jo praktik për tu realizuar.								
Kriteri 5. Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikën e mira të vendeve evropiane.	Masteri është licencuar me VKM 685, 25.08.2010. Objektivat e tij janë të përcaktuar qartësisht e mbështeten në një eksperiencë tashmë të konsoliduar të Njësisë bazë në lëminë e Administrimit Publik.								
Kriteri 6. Programet e ciklit të dytë "Master profesional" përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.	Praktikat profesionale si dhe marrëveshjet me institucionet në të cilat ato zhvillohen përputhen plotësisht me qëllimet dhe objektivat e programit. Ato kryehen në bazë të drejtimeve kryesore të programit si dhe të kompetencave që ai ofron.								
Kriteri 7. Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë "Master profesional" mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.	Nuk parashikohet një gjë e tillë. Gjuha e MPPP është shqipja. Programi është ndërtuar për nevojat specifike të tregut të punës në Shqipëri. Dhe MPPP pse është ndërtuar mbi praktika më të mira të programeve të ngjashme jashtë, objektivi mbetet ofrimi i formimit të kandidatëve potencialë apo punonjësve të administratës publike në Shqipëri.								
Kriteri 8. Programet e ciklit të dytë "Master profesional" mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësimin të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.	Nuk është e aplikueshme ose nuk del nga ekzaminimi i dokumentacionit.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi I.4				
Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	MPPP ofrohet nga një prej njësive bazë më të vjetra dhe më të konsoliduara të UAMD. Njësia bazë është e konsoliduar si në burimet njerëzore si ato materiale dhe ka kompetencat e nevojshme për të ofruar një program të tillë.			
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Fushat e kërkimit dhe studimit të njësisë bazë janë në lëminë e administrimit publik. Ky i fundit është një prej drejtimeve kërkimore të Njësisë Kryesore (shih Planifikimi strategjik i FShPJ, 2019-2021)			
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	MPPP është një program i cili është hartuar duke patur parasysh misionin e DAP, strategjinë e kërkimit shkencor dhe veprimtarinë kërkimore shkencore të anëtarëve të tij. Kjo del në pah nga lista e aktiviteteve shkencore të cilat janë kryesisht në fushën e Administrimit dhe Politikave publike (Aneksi 45), marrëveshjet ndërinstucionale (Aneksi 59), ekspertizës së personelit akademik.			
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	Nuk aplikohet.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Programi varet nga njësia bazë. Kjo e fundit është përgjegjësjë kryesore për mbarëvajtjen e tij. Marrëdhëniet me njësi të tjera të Universitetit kufizohen tek marrja e pedagogëve të jashtëm nga njësi të tjera bazë. Kjo siguron ndërdisiplinartetin e programit.
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	Institucioni ka lidhur një sërë marrëveshesh me institucione kombëtare, kombëtare lokale dhe ndërkombëtare. Në fushën specifike të aktivitetit të MPPP, institucioni ka marrëveshje me organizmat lokalë (shih Aneksin 59, 59/1), kombëtarë apo kombëtarë lokalë (shih Aneksin 60, 61). Po kështu Universiteti shfrytëzon marrëveshjet e mobilitetit Erasmus + (shih Aneksin 63,64,65)
Kriteri 3. Për realizimin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Praktikat profesionale realizohen në bazë të marrëveshjeve që institucioni ka me organizma të ndryshëm, aktiviteti i të cilave përkon me fushën e studimit të MPPP. Përpos organizmave lokalë, UAMD ka nënshkruar dhe marrëveshje me institucione kombëtare sikurse në rastin e RTSh, marrëveshje që specifike për kryerjen e praktikave të studentëve. (shih Aneksi 61)
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.	Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me institucionin që ofron praktikën. Secili student mbikëqyret nga një supervisor i institucionit pritës. Për këtë shih modelin e praktikës (Aneksi 67)
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Nuk ka informacione për një praktikë të tillë.
Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Nuk ka informacione për një praktikë të tillë. Dokumentacioni i servirur ofron vetëm shembuj të praktikave. Analiza e tregut të punës në anën tjetër kufizohet vetëm në përpunimin e pyetësorëve e nuk merr parasysh rezultatet e praktikave. Duke qenë se praktika është e detyrueshme, pak institucione, kryesisht ato të arsimit publik preokupohen të bëjnë një analizë të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit që kanë në qendër të tyre praktikat.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X





II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Ky kriter respektohet plotësisht. Kursi është ndarë në lëndë të cilat kanë nga 6 kredite ECTS. Kjo ndarje ofron fleksibilitet në transferimin e krediteve dhe mobilitetin e studentëve.
Kriteri 2 Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	Studentët në master janë dy kategori, ato që vijnë direkt nga sistemi B.A. ose ata që regjistrohen rishtas dhe vijnë nga fusha të ndryshme formimi. Kjo kategori është përgjithësisht e punësuar në A.Publike. Shprehitë që masteri u ofron i shërbejnë në punën e aktivitetin e tyre të përditshëm njëkohësisht formohen dhe figura profesionale në hartimin e politikave publike.
Kriteri 3 Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Programi synon të japë njohuri praktike dhe teorike mbi aspekte të përgjithshme e të veçanta të Politikave Publike. DAP e ka menduar masterin si mënyrë për të formuar hartues të Politikave Publike në të gjitha aspektet e tyre formale dhe materiale.
Kriteri 4 Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Qëllimi i Programit është të ofrojë njohuri e kompetenca të avancuara pa bërë thyrje të forta mes Ciklit BA dhe atij Master. Në këtë kuptim lëndët janë të ndërtuara duke përdorur cilësimin 'e avancuar'. Njohuritë bazë të marra në ciklin BA kështu thellohen. Masteri ka disa qëllime a-përgatitjen e specialistëve të Politikave Publike b-përgatitjen e specialistëve të Administrimit publik c- përgatitjen në nivel teorik për thellimin e njohurive në studimet doktorale
Kriteri 5 Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Programet janë ndërtuar konform legjislacionit në fuqi dhe përmbajnë të gjitha elementët e nevojshëm për një kurs të tillë.
Kriteri 6 Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe	Lëndët e modulet ndahen në tre grupe: formim juridik, ekonomik dhe teoriko politik. Ato ndahen në lëndë teorike dhe praktika e përgatitja e mikrotezës. Po kështu kursi parashikon dhe disa lëndë të cilat duhet të merren nga studentë të cilët nuk kanë një formim paraprak në fushën e administrimit dhe politikave publike.

me ngarkesën përkatëse në kredite.				
Kriteri 7 Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.	Parashikohet një ngarkesë prej 6 kreditesh për praktikën. Në bazë të dokumentacionit praktika zhvillohet në një institucion, kryesisht publik. Ajo ndiqet nga mentori i Universitetit dhe ai i institucionit. Më pas shoqërohet me dokumentacionin përkatës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				x

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Njësia bazë është Departamenti i Administrimit Publik. Kjo njësi funksionon në bazë të legjislacionit mbi Arsimin e Lartë, Statutit të Universitetit, Rregullores së Fakultetit dhe asaj të Departamentit. (Shih Aneksin 1,2,19 dhe 23)
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Njësia bazë është Departamenti i Administrimit Publik. Ajo përmbush detyrimet ligjore e nën ligjore për organizimin e strukturës akademike. Programet që ajo ofron janë konform qëllimeve, kompetencave dhe formimit të anëtarëve të DAP.
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.	Raportet janë të drejta. Shpërndarja e orëve dhe norma nuk tejkalohen. Çdo pedagog është përgjegjës për tre lëndë. Ngarkesa e pedagogëve të jashtëm me ata të brendshëm respektohet.
Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Njësia bazë ka stafin e nevojshëm për të përmbushur çdo detyrim ligjor që rrjedh nga ligji në fuqi. Në këtë program studimi Master Profesional “Politika Publike” (MPPP), gjatë vitit akademik 2019-2020 numri i stafit akademik i angazhuar nga UAMD ishte 12. Pranë zyrës së burimeve njerëzore është i depozituar dokumentacioni për stafin e angazhuar, përfshirë CV-të në format specifik dhe provat përkatëse. Të dhënat e personelit mblidhen, ruhen dhe përditësohen në dosjen individuale të stafit, që GVJ e kishte mundësi për të parë gjatë vizitës të





	institucioni (Ref. RVB, fq. 37-38; Takimi me përfaqësues të Zyrës së burimeve njerëzore).			
Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.	Njësia kryesore angazhon resurset e brendëshme për monitorimin e praktikave. Në disa raste ngarkesa e praktikave është e zhdrejtë në raport me numrin e pedagogëve që i ndjekin ato. Drejtuesi i njësisë u shpreh që këto janë raste të rralla por të paktën sigurohet që praktika të ndiqet sa më mirë nga pedagogët dhe të këtë një raport sa më të afërt me studentët praktikantë			
Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Programi ka një kordinator i cili mbikqyr mbarëvajtjen e kursit dhe zhvillimin e programit. Praktikat më së shumti koordinohen nga drejtuesi i njësisë bazë.			
Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.	Çdo program sikurse dhe Masteri Profesional në Politika Publike ka një kordinator. Roli i kordinatorit është monitorimi i mbarëvajtjes së Masterit. Po kështu ai raporton tek drejtuesi i njësisë për problemet apo sugjerimet e mundëshme për përmirësimin e programit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				x
Standardi II.3				
Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Informacionet e nevojshme ofrohen nga rregullorja e Fakultetit, analiza vjetore e punës dhe Kurrikula e programit.			
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Kurrikula është e organizuar në lëndë të detyrueshme 4 dhe 1 me zgjedhje në semestrin I. Në të dytin ka 4 lëndë të detyrueshme dhe 1 me zgjedhje e më pas praktika mësimore.			
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Lëndët janë të ndara në kredite 6 për 1 lëndë duke marrë si bazë sistemin ETSC. Po kështu ndarja është ajo e vitit në dy semestra.			
Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku	Plani mësimor është i qartë. Ai ndahet në dy semestra, me nga 30 kredite secili. Në semestrin e parë zhvillohen lëndë me natyrë teorike,			

përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	4 të detyrueshme dhe 1me zgjedhje. Në semestrine dytë ngarkesa teorike është me e ulët, 3 lëndë me 6 kredite secila. Në këtë semestër zhvillohet dhe praktika mësimore dhe mikroteza. Gjithesi paraqitja e mikrotezës në plan është formale pasi vlerësimi përfundimtar zhvillohet me provim. (shih Aneksin 24, f.10.			
Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Informacionet janë të ndara dhe nuk ofrohen në një paketë. Masterat sidomos ato profesionalë kanë një strukturë të ngurtë, e për shkak të kohës e bëjnë relativisht të pamundur transferimin megjithatë në dokumentacion jepen dhe shembuj të mobilitetit studentor, kryesisht në nivelin BA dhe jo Master (shih aneksin 73)			
Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programet e studimit përmbajnë listën e lëndëve, përshkrimin dhe objektivat e masterit. Është pak e paqartë si komunikohet përmbajtja e syllabuseve. Këto të fundit janë të detajuara dhe me gjasë i komunikohen vetë studentëve çdo fillim viti.			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Ndryshimet në program propozohen dhe hartohen nga DAP e më pas miratohen në Senat. Për procedurën shih (Aneksi 47, neni 32). Procedura aktivizohet çdo fillim viti nëse është e nevojshme.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Masteri është strukturuar në dy semestra, me nga 30 kredite secili. Në të kombinohen lëndë teorike, lëndë me zgjedhje, praktika dhe punimi i diplomës.
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve.	Lëndët në disa raste kanë cilësimin ‘ e thelluar’. Mendohet që ato janë vijimësi e studimeve të degës BA ku njohuritë bazë thellohen më tej. Përdorimi i këtyre cilësimeve lejojnë njëfarë ambiguiteti pasi termi i ‘thelluar’ do të thotë shumë ose asgjë, por nga ana tjetër kjo i lejon stafit akademik një lloj tolerancë në përzgjedhjen e materialeve të cilat
Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë	Lëndët janë të formimit juridik dhe ekonomik. Ndër to futen dhe lëndë të shkencave politike sikurse Marrëdhëniet Ndërkombëtare. Për nga natyra programi është i balancuar dhe arrin objektivat formuese. Ai i

<p>mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional.</p>	<p>ofrohet më së shumti funksionarëve të Administratës Publike të cilët janë në marrëdhënie pune e që vijnë nga formime të ndryshme akademike.</p>		
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teoripraktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Lëndët janë të formimit juridik dhe ekonomik. Ndër to futen dhe lëndë të shkencave politike sikurse Marrëdhëniet Ndërkombëtare. Për nga natyra programi është i balancuar dhe arrin objektivat formuese.</p>		
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Raporti i teorisë me praktikën respektohet në atë që Masteri Profesional ka më pak ngarkesë se ai Shkencor. Për këtë arsye praktika zë peshë më të madhe në këtë program. Në anën tjetër mastera të tillë në vende të tjera i dedikojnë më shumë kohë praktikës se sa kurrikulës mësimore. Në rastin shqiptar kjo ka të bëjë me mënyrën si janë hartuar rregulloret që rregullojnë praktikën brenda masterave. Praktika ka minimalisht 6 kredite, e pjesa tjetër është mësim në auditor.</p>		
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Formimi praktik është një fraksion i programit prej 60 kreditesh. Në këtë master ze peshë më shumë formimi teorik se sa ai praktik. Aspekti pozitiv është se disa prej lëndëve kanë orientim të fortë praktik gjë që plotëson praktikën. Këto lëndë janë Drejtim Projekti apo Sjellje Organizative e Avancuar.</p>		
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Programet e lëndëve mbështen në kombinimin e literaturës dhe leksioneve të shkruara nga pedagogët. Po kështu në syllabuse literature e detyrueshme është dhe në gjuhë të huaj, anglisht.</p>		
<p>Kriteri 8. Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Synimi i programit është i qartë e ndofta për këtë disa prej lëndëve marrin cilësimin 'e thelluar'. Këto dije lidhen ngushtë me përgatitjen profesionale të studentit dhe nevojat e sektorit publik.</p>		
<p>Kriteri 9. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi më shumë ofron kompetenca të cilat plotësojnë ato që studentët kanë marrë kryesisht gjatë procesit të punës. Programi ka si synim që të përgatisë studentët dhe për studime të thelluara në nivelin doktorat. Gjithsesi studimet doktorale formalisht kërkojnë të pasurit e një diplome Masteri Shkencor, ndërsa programi në fjalë është Masteri Profesional. Tregu i punës mbetet administrata publike. UAMD ka shumë marrëveshje me institucionet lokale. Shumica e studentëve i zhvillon praktikën në këto institucione. Duke parë kohëzgjatjen e Masterit, gjykojmë se ai i është përshtatur vazhdimisht kërkesave apo dinamikave që dalin nga marrëveshjet me institucionet e ndryshme të A.Publike në raport me kriteret e organizimit e formimit.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			x

Standardi II.5	
Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Personeli akademik angazhohet plotësisht në realizimin e programit të studimit. Departamenti i ka të gjitha resurset e duhuara njerëzore për të mbuluar fushat e studimit.
Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	Si personeli i brendshëm dhe ai i jashtëm kanë nivelin e duhur të kualifikimit. Po kështu personeli i jashtëm rekrutohet duke patur parasysh specifikisht kompetencat, fushën e studimit të masterit. Personeli i jashtëm po kështu ofron mundësinë e lidhjes me institucione specifike të arsimit të lartë. (Shih Aneksi 46, neni21)
Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	Njësia bazë ofron programe studimi të cilat arrin ti mbulojë jo vetëm fizikisht por dhe cilësisht me personel të kualifikuar. Ajo mbështetet dhe në kompetenca paralele që ofrohen brenda Universitetit nga njësi paralele.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Institucioni ve në dispozicion personelin disponibël. Për praktikat është e vështirë të arrihet një përputhshmëri mes profilit të pedagogut dhe insitucionit/fushës ku bëhet praktika. Temat e diplomës përputhen me natyrën e programit.
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e	Nuk aplikohet



orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6

Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Nuk ka një orientim të qartë që përmbush këtë pikë. Programi mbështetet në analizën e tregut të punës që kryhet nga njësia bazë, (aneksi 73/73.1). Në këtë raport përmenden intervistat me aktorët e interesuar, administratën publike të cilët japin mendimin e tyre për atë që ata si punëmarrës potencialë kërkojnë nga programet e studimit që UAMD ofron.			
Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.	Anketimi mbi tregun e punës përfshin dhe studentët. Për këtë janë intervistuar rreth 344 studentë të programit BA (Aneksi 73). DAP ka depozituar një dokument që i referohet vitit 2017 ku reflektohen ndryshimet që janë bërë pas anketimit të studentëve mbi programin. Procedura e marrjes parasysh të sugjerimeve dhe ndryshimeve të mundëshme është e shpjeguar në dokument. (shih Aneksi 73 dhe 74).			
Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.	Universiteti ka ndihmuar në krijimin e organizatës ALUMNI të UAMD. Me ndihmën e Universitetit kjo organizatë mban lidhjet me studentët dhe shpërndan një çmim për arritjet e ish studentëve në profesionet e tyre, (aneksi 52).			
Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi.	Analiza e tregut të punës shërben për përmirësimin e kurrikulës. Për këtë, si shembull ofrohet një dokument i vitit 2017, (aneksi 74).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				x

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1				
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Nga analiza e dokumentacionit nuk del ndonjë orientim institucional për përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies. Kur flitet për metoda inovative, diskutimi mbahet në nivel të përgjithshëm. Metodatat e reja të mësimdhënies mbeten më shumë në rrafshin e qëllimeve institucionit se sa në aplikimin e tyre praktik.			
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Instrumenti më i rëndësishëm për monitorimin e aftësive mësimdhënëse mbetet pyetsori i cili zhvillohet çdo vit nga NjSBC. Një pjesë e këtij pyetsori merret dhe me cilësinë e mësimdhënies, (Aneksi 134). Po kështu dhe në analizën e tregut të punës, merren mendimet e studentëve mbi cilësinë e Masterit.			
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Studentët agazhohen në vlerësimin periodik të studimeve në përgjithësi përmes pyetsorit, (Aneksi 134 dhe Aneksi 73/73.1). Ankesat trajtohen nga Dekani e më pas i kalohen departamentit për shqyrtim. Ky i fundit ngre një komision verifikimi të tyre.			
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Rezultatet bëhen publike. Ato që kanë të bëjnë me pedagogët i jepen personalisht atyre. Departamenti merr në shqyrtim rezultatet e bën analizën e tyre. Më pas merren masat e nevojshme për të adresuar problemet që dalin nga analiza e të dhënave.			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Nuk del në pah diçka e tillë. Rezultatet diskutohen në nivel departamenti.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Format e mësimdhënies janë ato klasike për studimet në shkencë humane. Në UAMD formati parashikon vetëm leksione prej tre orësh, pra jo seminare. Nëse ky mund të jetë problem për nivelin BA, patur parasysh numrin e madh të studentëve, nuk është problem për ciklin Master. Studentëve u kërkohen në bazë të lëndëve të realizojnë projekte të përbashkët e punë në grup.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>UAMD ka një rregullore për studentët me aftësi të kufizuara, aneksi 55. Universiteti ka krijuar një njësi të veçantë në varësi të Dekanit të Studentëve, e cila monitoron e ndihmon personat me aftësi të kufizuara të kenë akses të barabartë në sistem.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënies, objektivat formuese dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Institucioni mbështet pedagogun në procesin e mësimdhënies. Nuk ka orientime të qarta për përdorimin e metodave inovative. Struktura e mësimdhënies ndarë në leksione tre orëshe nuk ofron ndonjë fleksibilitet të madh për përdorimin e metodave inovative. Rëndom këto pritshmëri mbështeten në syllabus dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit në funksion të evolucionit të tregut të punës.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Personeli akademik është mësë i kualifikuar në fushat e studimit të cilat prek program. Metodën e koncepteve që përdoren gjenden të përfshira në syllabus. Rregullorja e FShPJ e përcakton këtë në nenin 48. Formatin e syllabusit përcakton qartë organizimin e lëndës, kriteret e vlerësimit, qëllimet etjer. (shih Aneksi 19, neni 48).</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Mendimet e studentëve reflektohen në pyestor i cili administrohet nga NjSBC, e me pas rezultatet e tij diskutohen në nivel departamenti. Sugjerimet e studentëve gjejnë vend e më pas reflektohen në programin e studimit.</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe</p>	<p>Kjo mbetet në autonominë e pedagogut i cili orienton dhe organizon mësimin sipas kurrikulës dhe praktikave më të mira të institucionit.</p>

diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.									
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Një prej elementëve që programi inkurajon është të menduarit kritik dhe aftësimi të studentit të veprorë me autonomi në zgjidhjen e problemeve me të cilat ata përballen. Për këtë ata gjejnë mbështetje nga mësimdhënësit.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.3	
Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Njësia bazë dhe mësimi zhvillohen në ambientet e kampusit të UAMD, Kënetë, Durrës. Ky kompleks ndërtuar në vitin 2005 është projektuar për të qenë universitet e është një ndër të paktat investime publike për një institucion të arsimit të lartë. Ambientet janë të reja e modern.
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.	Ambientet janë të dedikuara për mësimdhënie. Përpos klasave të vogla, ka dhe disa salla me kapacitet 90 vende në formën e auditoreve. Të gjitha klasat janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme.
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.	Interneti ëireless është disponibël dhe i lirë për tu përdorur nga studentët. Gjatë vizitës nuk pamë një sallë të dedikuar për shfrytëzimin e pajisjeve kompjuterike. Gjithsesi IT është përdorur gjerësisht nga pedagogët për mësimdhënie, sidomos në fazat e lehtësimi të masave andikovid në maj të vitit 2020.
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Literatura bazë garanton dijen e nevojshme për zhvillimin e mësimit. Praktika në UAMD është ajo e hartimit të cikleve të leksioneve të cilat përditësohen nga pedagogët vit mbas viti. Kjo është gjykuar si një mënyrë fleksibël dhe e përshtatshme në mungesë të përkthimeve shqip.
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të	Biblioteka e institucionit ka rreth 12000 libra. Botimet për drejtimet kryesore të studimit janë disponibël. Përsa i përket hapësirës ajo është relativisht e vogël, pasur parasysh godinën dhe ambientet e tjera.

mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Biblioteka ka tre funksione: atë të bibliotekës, laboratorit të informatikës dhe sallës së studimit.			
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Studentët kanë akses në disa mijra tituj elektronik si dhe në sistemin EBSCO i cili mundëson konsultimin e artikujve on line.			
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Nuk ka ambiente të përshtatshme për punë laboratorike ose hedhje të dhënash. Salla e dedikuar si laborator informatik mungon.			
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Programi nuk përdor platforma online përveç eksperiencës së marrë gjatë emergjencës covid ku u përdorën platforma të ndryshme të lira online.			
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Studentët kanë mundësi të shfrytëzojnë sistemin elektronik Pitagora përmes të cilit regjistrojnë lëndët që duhet të frekuentojnë sipas planit të studimit. Po përmes këtij sistemi gjenerohet dhe orari. (shih Aneksin 108). Studentët përdorin po kështu dhe sistemin Aula (Aneksi 49).UAMD përdor gjerësisht dhe sistemin Clean Score. Ky sistem ofrohet nga një partner i jashtëm i cili ofron platformën e dedikuar përmes të cilës korrigjohen provimet apo përpunohen të dhënat e pyetësorëve të ndryshëm.			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Njësia bazë por dhe UAMD kanë hartuar një udhëzues praktik për shkrimin e mikrotezës (shih Aneksin 68). Po kështu pedagogët udhëzojnë e mentorojnë studentët gjatë shkrimit të temës së diplomës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Institucioni orienton njësitë bazë në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Për këtë janë krijuar të ashtuquajtuarat 'Grupet mësimore kërkimore shkencore'(shih Aneksi 18, neni 19), që udhëhiqen nga një prej anëtarëve të departamentit. Detyrat e këtij grupi janë: -hartimi i kurrikulave që mbulon grupi -hartim program lëndësh të reja për tu propozuar në njësinë bazë

	-mbikqyrja e respektimit të programeve.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Njësia bazë, ka krijuar tre 'Grupe mësimore kërkimore shkencore', të cilat respektojnë drejtimit studimore dhe kompetencat shkencore të anëtarëve të departamentit. Këto grupe bëjnë të mundur lidhjen mes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	Mësimdhëina në UAMD mbështetet në strukturën fikse të tre orëve të leksionit. Ka pak autonomi në këtë drejtim. Metodatat inovative të mësimdhënies do të kërkonin një fleksibilitet në organizimin e mësimdhënies.
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Kualifikimi i personelit shkencor, përveç rastit kur ky i fundit kryen doktraturën në Universitet, i lihet në dorë vetë pedagogut. Nuk ka mbështetje për pedagogun, përveç revistës së universitetit ose organizimit të konferencave shkencore në nivel Universiteti ku siç theksohet nga pedagogët, ata nuk janë subjekt i tarifave financiare që aplikohen. Pedagogët nuk financohen për konferenca jashtë shtetit por mbështeten në shfrytëzimin e programeve të shkëmbimit Erasmus+. Në anën tjetër, Universiteti mbështet projekte kërkimore shkencore me fondet e veta, të paktën për vitin 2017. Për më shumë shih aneksin 75.1
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Trajnimet e personelit akademik janë sporadike, në varësi të sistemeve të reja që implementohen në UAMD.
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Personeli akademik është përgjegjës për mbarrëvatjen e programeve dhe angazhohet për përmirësimin e mësimdhënies. Një pjesë e mirë e informacioneve për përmirësimin e mësimdhënies vjen nga analizat e ndryshme si ajo e tregut të punës apo dhe hulumtimi që organizon NjSBC mbi cilësinë.
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Nuk ka indikacione për këtë.
Kriteri 8. Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të	Universiteti angazhon lektorë të jashtëm të cilët ofrojnë ekspertizën e tyre në lidhje me probleme e tema të ndryshme që përputhen me qëllimet e DAP dhe programet studimore që kjo strukturë ofron. Po kështu DAP shfrytëzon mobilitetet Erasmus+ jo vetëm për mësimdhënie por edhe për formimin e vazhdueshëm të personelit akademik.

mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret e vlerësimit parashikohen në rregulloren e Fakultetit., neni 21, (Aneksi 19, neni 54.)Format e vlerësimit i komunikohen studentëve nga pedagogët çdo fillim kursinë sillabus. Struktura e provimit me shkrim cilësohet si forma e vetme vlerësimit në UAMD (Aneksi 19, neni 54), gjykohet nga pedagogët si relativisht e ngurtë pasi lëndët kanë formate të ndryshme dhe provimi me alternativa kufizon kontrollin e dijës.			
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Studentët çdo fillim viti informohen për mënyrën e format e testimit. Për studentët e ciklitMPPP UAMD këto forma janë të njohura dhe më parë pasi në pjesën dërrmuese përdoret forma e kontrollit të dijës të provimit me shkrim me alternativa si dhe komponentët e tjerë plotësues si pjesmarrja, detyrat e kursit dhe projektet.			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	UAMD ka një strukturë të ngurtë vlerësimi e përbërë nga katër komponentë: -provimi me shkrim -pjesmarrja në seminare -detyra kursi -projekte Pedagogu nuk ka autonomi në përzgjedhjen e formës së vlerësimit. Nëse kërkon formë alternative vlerësimi ahëre duhet ta kërkojë me shkrim tek përgjegjësit të departamentit. Ky i fundit e miraton ose jo. Në rast mos dakordësie vendimi i takon Asamblesë së Departamentit. Komponenti më i rëndësishëm i vlerësimit mbetet provimi me shkrim, kryesisht me pyetje me alternativa. Pedagogët u shprehën se kjo formë është shumë e ngurtë por ndiqet rëndom si praktikë. Kohët e fundit UAMD po shfrytëzon projektin Clean score, korrigjimin elektronik të provimeve. Struktura e Clean score me atë të UAMD përputhet e kështu forma e testimit me pyetje me alternativa është bërë akoma e më e vështirë për tu ndryshuar nga pedagogët.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	UAMD ka një strukturë që privilegjon kontrollin e vazhdueshëm të dijes gjatë vitit. Kjo reflektohet kryesisht në ndarjen e provimit të kontrollit të dijes në dy periudha, atë të ndërmjetme dhe atë përfundimtare. Forma e kontrollit është me shkrim, përmes një provimi me pyetje me alternative.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	UAMD ka përdorur historikisht formën e testimit me shkrim, provim me pyetje me alternativa. Përpara provimit, pedagogu depoziton në pranë drejtuesit të çelësat me përgjigjet e duhura. Kontrolli i tyre ka qenë manual dhe mekanik, sipas çelësit. Kjo strukturë është përmirësuar me futjen e sistemit Clean score që perjashton pedagogun nga korrigjimi të cilin e kryen sistemi.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Procesverbali final mban firmën e pedagogut, shefit të departamentit, kryesekretares dhe dekanit. Me gjasë ky mund të konsiderohet si një komision.
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Me adoptimin e sistemit Clean score, pedagogu ka pak mundësi ndërhyrje në korrigjim. Nuk është e qartë nëse tezat janë anonime apo nëse përdoren forma që sigurojnë këtë anonimitet.
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Diçka e tillë nuk evidentohet nga dokumentacioni i paraqitur.
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Plagjatura nuk tolerohet dhe pse nuk del në pah përdorimi i ndonjë platforme që e evidenton plagjiaturën sikurse mund të jetë Turnitin. Ky parashikim gjendet në rregulloren e UAMD posaçërisht në nenin 70 të saj.
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Rezultatet e kontrollit të dijes bëhen publike sikurse e përcakton dhe rregullorja.

Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Ekziston një procedurë ankimimi nga studenti për vlerësimin, e cila vlerësohet nga një komision i ngritur posaçërisht. Ky komision në bazë të kërkesës procedon me ballafaqimin e testit me çelësin. Kjo procedurë parashikohet në rregulloren e UAMD. Studenti ka kohë tre ditë nga dalja e rezultateve të ankohet tek Drejtuesi i Njësisë kryesore i cili nëse e sheh të arsyeshme ja kalon atë Drejtuesit të njësisë bazë i cili procedon me ngritjen e komisionit vlerësues.			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Kjo procedurë parashikohet në rregulloren e UAMD dhe praktika dokumentohet e arkivohet.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7 Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programet e studimit janë organizuar në formën e rrrathëve koncentrikë. Programet BA orientohen drejt atyre Master. Një pjesë e lëndëve kanë cilësimin e thelluar, nga ato bazike që me gjasë kanë ndjekur gjatë ciklit BA. Për studentët që nuk kanë një formim paraprak në administrim por që vijnë nga formime të ngjashme sikurse shkenca politike apo juridike, ofrohen disa lëndë bazë të cilat me gjasë i ndihmojnë ata në përballimin e sukses të programit.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	MPPP ofron zhvillimin e aftësive në orientimin e hartimin e politikave publike. Aftësitë e veçanta orientohen kah zhvillimit të kapaciteteve organizative dhe analitike të studentëve dhe formimin e tyre duke patur parasysh praktikat më të mira.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Syllabuset përmbajnë komponentë shtesë përveç atyre që kanë të bëjnë me qëllimin e lëndës dhe programin. Në to shpjegohen dhe analizohen pritshmëritë e pedagogëve mbi kompetencat dhe aftësitë që studentët duhet të përftojnë në fund të lëndës.
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	Elementët më të rëndësishëm apo makroçështjet që programi kërkon të zhvillojë ofrohen në syllabus e më pas ato reflektohen në testin përfundimtar. Kjo mbetet në autonominë mësimdhënëse të çdo pedagogu dhe formës/mënyrës që ai përzgjedh për ti orientuar studentët në testin përfundimtar.

Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Nuk është e qartë, por të gjitha konferencat shkencore dhe aktivitetet jashtë kurrikulare në njësinë bazë ose që zhvillohen në bazë universiteti janë të hapura për studentët.			
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Objektivi i lëndëve të ofruara në MPPP është përgatitja e studentëve me kompetenca e njohuri të caktuara në fushën e menaxhimit të politikave publike, e që më pas të ushtrohen gjatë kryerjes së praktikës e më pas në ato vende pune ku studentët do të punojnë.			
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Kjo është pjesë e procesit mësimor dhe organizimit të veçantë të lëndëve. Një prej komponentëve të vlerësimit të studentëve është dhe puna në grup që studentët mund të zhvillojnë gjatë studimeve. (Aneksi 23).			
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.	Njësia bazë ka një plan kërkimi shkencor i cili lidhet me fushën e studimit të programit. Po kështu njësia bazë organizon aktivitete të veçanta si vizita studimore pranë institucioneve të ndryshme apo përfshirjen në projekte të studentëve me aftësi të ndryshme (Shih Analizën vjetore të DAP, f.22-23).			
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Institucioni, të paktën gjatë vitit 2017 ka mbështetur me fonde të brendshme një projekt për njësi bazë. Në FShPJ janë mbështetur tre të tillë me vlerë të përafërt 1.800.000 lekë secili. DAP ka zhvilluar një projekt mbi analizën e performancës së administratës publike në disa rrethe të vendit. Pedagogët nuk marrin ndihma financiare nga universiteti për të zhvilluar konferenca jashtë shtetit. Sa më sipër varet nga faktorë të jashtëm si projektet apo marrëveshjet e shkëmbimit Erasmus+ gjithsesi siç theksohet nga pedagogët pjesmarrja në çdo aktivitet shkencor që organizohet nga UAMD është pa pagesë për pedagogët e këtij universiteti.			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Kjo mbetet në dorë më shumë të Universitetit i cili nëshkruan marrëveshjet e bashkëpunimit. Gjithsesi njësia bazë mbështet dhe orienton studentët përsa i përket mobilitetit.			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	<p>Praktika profesionale zhvillohet jashtë institucionit, në institucione pritëse. Këto janë kryesisht insitucione publike me të cilat UAMD ka marrëveshje të posaçme. Natyra e MPPP e faciliton këtë proces pasi dijet e marra në të mund të aplikohen në thuajse të gjitha insitucionet e administratës publike. Të gjitha marrëveshjet tip që janë paraqitur në dokumentacion e tregojnë këtë.</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	<p>Ky kriter nuk është i aplikueshëm për masterin në fjalë.</p>			
<p>Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.</p>	<p>Praktika ndiqet nga dy udhëheqës, një i insitucionit dërgues e një i atij pritës. Në fund të saj plotësohet një formular nga institucioni pritës dhe një raport nga studenti. Këto dokumente përmbajnë vlerësimet përkatëse për performancën e studentëve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.9 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Institucioni ka hartuar një procedurë të tillë. Kjo gjendet në Aneksin 47. Procedura dhe rezultatet bëhen publike.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Në rregulloren e Masterit parashikohet kryerja e tezës ndërkohë që në takimet që u bënë u evidentua fakti se studentët bëjnë provim përfundimtar. . Gjithsesi në departamenti ka hartuar një paketë me udhëzime për mikrotezën. Sipas kësaj çdo student ndiqet nga pedagogu përkatës, i cili përzgjidhet nga student ose caktohet kryesisht nga Departamenti në rastet kur e parashikon rregullorja. (shih Aneksi 68)</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/</p>	<p>Nuk aplikohet për këtë program</p>

modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.	Rregullorja është evazive në këtë pikë. Nuk parashikohet se si zgjidhet udhëheqësi apo si orientohet studenti në përzgjedhjen e temës. Në anën tjetër, studentit i ofrohet nga departamenti një paketë orientuese mbi procedurën, stilin dhe mënyrën e paraqitjes së temës. Në takimin me drejtuesit e departamentit u tha se studentët kryejnë një provim final e jo mikroteze. (shih Aneksi 23, Rregullorja e MPPP, neni 20,21,22)
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Nuk është e përfshirë në rregullore. Mbetet tek raporti pedagog udhëheqës –student të përcaktohet si praktikë. Gjithsesi natyra e MPPP implikon përdorimin e matjeve të ndryshme e këto matje përdoren apo aplikohen nga studentët në tezat e diplomës. (shih Aneksi 23, Rregullorja e MPPP, neni 20,21,22)
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Rregullorja e masterit parashikon se kriteri bazë mbi të cilin ndërtohet raporti udhëheqës student është ai i mbikqyrjes. Në bazë të vlerësimit të udhëheqësit tema mund të kalojë ose jo për mbrojtje në komision. Në realitet vlerësimi final bëhet përmes provimit përfundimtar. (shih Aneksi 23, Rregullorja e MPPP, neni 20,21,22)
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë.	Format e vlerësimit final për MPPP janë dy, me notë dhe temë diplome: a) Forma e përdorur deri më tani në për vlerësimin final të programit është provimi me shkrim. Studenti vlerësohet me notë përfundimtare. (Shih Minutat e takimit) b) Përsa i përket temës së diplomës, procedura e vlerësimit është si më poshtë vijon: Vlerësimi bëhet me notë nga komisioni pas mbrojtjes së diplomës. Studenti paraqet punën përmes një prezantimi ppt për një sasi kohe të caktuar. Në bazë të performancës dhe indikacioneve të tjera, komisioni vendos për notën. (Aneksi 23, neni 22)
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Studentët pajisen me dokumentat përkatëse sikurse parashikon ligji. Gjithsesi gjatë vizitës u evidentua mungesa e regjistrit përkatës për masterin. Sipas sekretarisë me gjithë kërkesat e vazhdueshme studentët nuk janë të regjistruar në regjistrë. Edhe se është program i ri dhe diploma dhe suplementi I diplomes do të leshohen pasi të merem akreditimi dhe pasi të regjistroj formen e diplomes QSHA.
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Vlerësimi për këtë kriter është riparë pas komenteve të dërguara nga UAMD, DAP (Memo e UAMD, f.4). Në bazë të sqarimit të bërë nga institucioni përgjegjës studentët dhe alumnit mund të kërkojnë në përfundim të studimeve programin përkatës që gjendet fizikisht në mjediset e UAMD dhe elektronikisht në faqen e universitetit.
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe	Institucioni ruan dokumentacionin dhe i përgjigjet studentëve kur këta e kanë të nevojshme duke i vënë në dispozicion informacionet e nevojshme.

paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR
REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**


Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Në këtë program studimi Master Profesional “Politika Publike” (MPPP), gjatë vitit akademik 2019-2020 numri i stafit akademik i angazhuar nga UAMD ishte 12. Pranë zyrës së burimeve njerëzore është i depozituar dokumentacioni për stafin e angazhuar, përfshirë CV-të në format specifik dhe provat përkatëse. Të dhënat e personelit mblidhen, ruhen dhe përditësohen në dosjen individuale të stafit, që GVJ e kishte mundësi për të parë gjatë vizitës te institucioni (Ref. RVB, fq. 37-38; Takimi me përfaqësues të Zyrës së burimeve njerëzore).</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Institucioni për rekrutimin e personelit akademik ka procedurë përcaktuar te Statuti dhe Rregullore e universitetit, te cilat përcakton procedurat e rekrutimit të personelit akademik. Plani strategjik e përcakton politikat e rekrutimit të personelit akademik. Procedurat e rekrutimit është në përshtatje me aktet ligjore dhe me rregulloret. Procedura e rekrutimit ndiqet nga Zyra e Burimeve Njerëzore e institucionit (Ref. RVB, fq. 37-38; Aneks 1 – Dok. Statuti UAMD; Aneks 2 – Dok. Rregullore UAMD; Takimi me përfaqësues të Zyrës së burimeve njerëzore).</p>
<p>Kriteri 3 Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Procedura e rekrutimit e personalit është përcaktuar te Statuti i universitetit. Kriteret të posaçme dhe specifike shpallen publikisht te faqja zyrtare të universitetit dhe te faqja e internetit të departamentit së administratës publike të Republikës së Shqipërisë dhe përzgjedhja bëhet me konkurs. Por kërkesat e aplikimit janë shumë të vështira pasi dokumentet që mund të kërkohen më vonë nga aplikantët fitues kërkohen me aplikimin fillestar të bërë. Për shembull, kërkimi i tre letrave rekomanduese dhe dokumenteve të noterizuara në fazën e aplikimit nuk mundëson qasje të barabartë në punë (Ref. RVB, fq. 37-38; Aneks 1 – Dok. Statuti UAMD; Aneks 2 – Dok. Rregulllore UAMD; Takimet me stafin akademik dhe përfaqësues të Zyrës së burimeve njerëzore).</p>
<p>Kriteri 4 Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë</p>	<p>Procedura nis me evidentimin e nevojës nga ana e njësisë bazë – Departamenti Administrim Publik (DAP). Më pas bëhet publikimi i këtij pozicioni në faqen e internetit UAMD dhe te faqja e internetit të departamentit së administratës publike të Republikës së Shqipërisë. Përzgjedhja i kandidatëve kalon në dy faza: shqyrtimi i</p>

përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	dokumentacionit dhe intervistimi i kandidatëve të përzgjedhur nga një komision i posaçëm me përfaqësues nga dekanati dhe rektorati. Emërimin e bënë Zyra e burimeve njerëzore. Përzgjedhja e personelit bëhet duke marrë në konsideratë mungesat në stafin e brendshëm sikurse dhe ekspertizat dhe ngarkesën mësimore. Lektorët e lëndëve që ata japin në kuadër të MPPP kanë plotësuar kriteret siç janë: eksperiencë në kërkim shkencor dhe mësimdhënie, përputhje me kërkesat e kurrikulës së MPPP-ut në lidhje me lëndët, etj(Ref. RVB, fq. 37-38; Dok. minutat e takimeve në IAL; Aneks 1 – Dok. Statuti UAMD; Aneks 2 – Dok. Rregullore UAMD; Takimet me stafin akademik dhe përfaqësues të Zyrës së burimeve njerëzore).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Mjediset e vendosura në dispozicion për stafin akademik e programit të studimit MPPP janë gjithsej 8ambiente zyrash. Ambjentet e punës janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për realizimin e detyrave nga ana e stafit akademik dhe administrativ. Është konstatuese që institucioni ka mjediset me kushte funksionale dhe të përshtatshme. Gjithashtu, institucioni organizon aktivitete të ndryshme si forume dhe konferenca për përmbushjen e objektivave të programit MPPP. Vërehet mungesa e kalendarit të përditësuar për aktivitetet vjetore (Ref. RVB, fq. 38; Aneks 121 - Dok. Të dhëna për kapacitetin e Godinës Nr.1 Kampus; vizita në institucion; takimet te institucioni).
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Institucioni realizon disa incentive të cilat angazhojnë dhe nxisin stafin akademik për zhvillim profesional. Stafi përfshihet në organizimin dhe realizimin e konferencave shkencore, projekteve kërkimore, mobilitete si dhe përmes skemës së financimit të kërkimit shkencorë me një fond në dispozicion prej 250.000 LEK për çdo departament për botime të artikujve shkencor dhe për të marrë pjesë në aktivitete akademike apo aktivitete trajnuese dhe zhvilluese të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit. Personeli që mbulon dhe administron programin e studimit pati mundësi për t'u trajnuar në kuadër të programit Erasmus. Nga takimi në institucion por edhe nga raportimi në RVB u informuam që çdo vit zhvillohen konferenca (për shembull konferenca per qeverisja lokale në Shqipëri me Universtitetin Sophia Antipolis Nice, France), publikime (për shembull revista "Interdisciplinary Journal of Research and Development"), trajnime dhe aktivitete në rang universiteti në kuadrin e Fakultetit të Edukimit për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit. Institucioni kërkon që stafi të ketë një pjesëmarrje në konferencë dhe një botim në vit. Anëtarët e stafit

	<p>akademik gjithashtu kanë marrë pjesë në kryerjen e akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit përmes ASCAL. Përfshirjes estafit në projektsh hulumtuese kombëtare dhe ndërkombëtare të cilat janë të rëndësishëm në kuadër të zhvillimit të vazhdueshëm të personelit janë të kufizuar. (Ref. RVB, fq. 38-39; Takimet me anëtarët e GVB, stafin akademik, dhe Dekani i FSHPJ/Përgjegjësi i DAP).</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Universiteti inkurajon përmes përfshirjes së stafit akademik në projekte kërkimore me partnerë kombëtar dhe ndërkombëtar, si është programi Erasmus, mundësi për të përfutur nga eksperiencia dhe shkëmbimi i metodave inovative të mësimdhënies. Institucioni e ka shpallur mbështetje për stafin në kërkim shkencor nëpërmjet projektsh (për shembull projekti i DAP-it financuar nga institucioni ‘Qeverisja dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm’) dhe me fondin për botime të artikujve shkencor. Stafi akademik kanë përdorur metodat inovative dhe teknologjitë e reja në mësimdhënie. Anëtarët e stafit janë aktiv në kërkim shkencor nëpërmjet pjesëmarrjes në konferenca dhe botimeve të artikujve shkencorë. Vërehet mungesa e aktiviteteve dhe mbështetje institucionale për anëtarët e stafit për të ndërmarrë metoda inovative të mësimdhënies dhe përdorimit të teknologjive të reja. Programi i studimit MPPP është një platformë që e ka ndërtuar ura bashkëpunimi me institucione të tjera në vend (për shembull ‘Dhoma e tregtisë dhe Industrisë – Durrës’, ‘Bashkia Maliq’, ‘Radio Televizioni Shqiptar’, ‘Albanian-American Development Foundation’) dhe jashtë saj (për shembull ‘Bielefeld University of Applied Sciences’) (Ref. Aneks 75. Projekti kërkimor shkencor DAP; Takimet me anëtarët e GVB dhe stafin akademik).</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Në informacionin e paraqitur në RVB lidhur me personelin shpjegohet organizimi i këtyre strukturave si edhe lista e personave në secilën strukturë. Dok. Udhezim 29 date 10.09.2018 për veprimtarinë dhe ngarkesat e personalit akademik përcakton kriteret dhe mënyrën e shpërndarjes së ngarkesës mësimore në funksion të angazhimit optimal të burimeve njerëzore. Stafi i angazhuar në programin e studimit MPPP është me tituj dhe grada në fushën e programit të ofruar. Për vitin 2019-2020 ky program studimi nga ana e UAMD mbulohet nga 3 Profesor Doktor, 3 Profesor të Asociuar dhe 6 Doktor Shkencash. Profesionalizmi dhe kualifikimi i tyre mundëson përmbushjen e objektivave të programit dhe angazhimi i tyre është në nivelin e kërkuar. Institucioni angazhon personelin e duhur si për të ofruar programin ashtu edhe për aktivitetet plotësuese (Ref. RVB, fq. 39; Aneks 126 - Dok. Udhezim 29 date 10.09.2018; Takimet me anëtarët e GVB dhe me stafin akademik).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Studentët e programit MPPP kanë në dispozicion një infrastrukturë fizike, didaktike dhe logjistike të Kampusi Universitar – Godina nr 1, e mjaftueshme dhe të përshtatshme për përmbushjen e realizimit të pjesët teorike të programit të studimit. Institucioni ka salla të kapaciteteve të ndryshme të ndara në auditore me 425 vende. Numri i klasave është i mjaftueshëm për realizimin e programit të studimit (Ref. RVB, fq. 39; Aneks 121 - Dok. 2018 të dhëna për kapacitetin e Godines Nr. 1 Kampus; Aneks 122 – Dok. Permbledhese Kapaciteti UAMD; Vizita në institucion).
Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Mjediset e ofruara nga institucioni janë të përshtatshme dhe të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor. Auditorët janë të pajisur me mjete audio vizive si PC, projektor, internet dhe foni. Përveç kompjuterëve të gjendur në klasat studimore, ka pajisje kompjuterike edhe në bibliotekë. Vërehet mungesa e një sistemi e menaxhimit të mësimtnga ana e stafit akademik që do të mundësonte përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të aksesueshme në çdo kohë për materialet e hedhura nga pedagogu (RVB, fq. 39; Aneks 49 - Dok. Manual Aula UAMD; Aneks 123 – Dok. 2019-2020 Tabela për Vlerësimin e Kapaciteteve 2019-2020; Vizita në institucion; Takimet me stafin akademik dhe studentët).
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Programi i studimit ka në dispozicion auditore të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektore dhe foni në rastin e sallave të leksionit. Laboratorët e informatikës janë pajisur me softëare-t përkatës në mënyrë që t’i shërbejnë sa më mirë programit mësimor. Por për natyrën që ka ky program mësimor nuk ka të nevojshme praktika në laborator (RVB, fq. 40; Aneks 122 – Dok. Permbledhese Kapaciteti UAMD; Aneks 53 – Dok. Rregullore IT UAMD; Vizita në institucion).
Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.	Për natyrën që ka ky program studimi nuk është i nevojshëm përdorimi i laboratorë të teknologjisë së informacionit (Ref. RVB, fq. 40; Aneks 53 – Dok. Rregullore IT UAMD; Vizita në institucion).
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	Kapacitetet e UAMD dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të tjera mundësojnë mjedise të përshtatshme për realizimin e veprimtarive praktike dhe aktivitetëve të tjera. UAMD garanton infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e veprimtarive praktike në institucion sikurse dhe bashkëpunon me institucione dhe organizata të tjera në vend në funksion të kryerjes së praktikave profesionale të studentëve. Studentët e këtij programi studimi kanë kryer praktikën e



	tyre profesionale në institutucone të ndryshme në Durrës, Tiranë, Mirditë, etj. (Ref. RVB, fq. 40; Aneks 67 - Dok. Një praktikë konkrete e praktikës profesionale; Takimet me anëtarët e GVB dhe studentët; Vizita në institucion).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Në nivel universiteti gjithsej janë tre ambiente biblioteke. Biblioteka e vendosur në godinën kryesore si dhe te Kampusi Universitar me sallë leximi si dhe me sallën e kompjuterave, mundëson përdoruesve përdorimin e kompjuterave, zhvillimin e aktiviteteve, trajnim mbi përdorimin e katalogut online, etj. Biblioteka e UAMD ka nënndarjen e saj të lidhur me funksionin e promeve të studimeve të programet e studimit të Fakultetit i Shkencave Politike - Juridike. Studentët e programit MPPP kanë mundësi të shfrytëzojnë edhe bibliotekën elektronike të ofruara nga Biblioteka e UAMD. Vërehet mungesa e aksesit drejtpërdrejt te burimet e bibliotekës me kartën e universitetit pa anëtarishte Biblioteka (Ref. RVB, fq. 40; Aneks 50 – Dok. Rregullorja e Bibliotekes UAMD; Vizita te institucioni).
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Literatura te Biblioteka është e bollshme (rreth 12000 tituj) me botime në shqip, anglisht dhe gjuhë të tjera. Biblioteka ka infrastrukturë për aksesimin e titujve të librave në bibliotekat online. Ekziston nevoja që Biblioteka të prodhojë dhe azhurnojë rregullisht listën e titujve sipas programeve të studimit (Ref. RVB, fq. 40-41; Dok. Rregullorja e Bibliotekes UAMD; Vizita te institucioni).
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Regjistrimi dhe përdorimi i infrastrukturës dhe shërbimeve në bibliotekë, përfshirë bibliotekat on-line, është pa pagesë (Ref. RVB, fq. 41; Aneks 128 – Dok. Manual Biblioteka Online; Aneks 129 – Dok. Biblioteka Online të dhëna mbi materialet e disponueshme; Vizita te insitucioni).
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Në ambjentin e Bibliotekës ndodhet salla e kompjuterave e cila i mundëson përdoruesve përdorimin e kompjuterave, zhvillimin e aktiviteteve, trajnim mbi përdorimin e katalogut online, etj. Biblioteka mundëson kërkim të informacionit on-line, në sallën e leximit, skedarë elektronikë, lehtësira në kërkimin bibliografik të informacionit, mundësi shfletimi të literaturës elektronike, pranë kompjuterave të

	<p>sallës. Biblioteka e UAMD ka Katalogun Online të Integruar, për menaxhimin e fondit të saj. Katalogu ofron një version të avancuar në kërkimin e informacionit. Përveç përshkrimit bibliografik, katalogu ofron falas në formatin elektronik artikuj, teza, kërkimin shkencor dhe disertacionet e stafit akademik të UAMD-së. UAMD është gjithashtu abonuar në libraritë elektronike siç janë EBSCO, JSTOR, biblioteka dixhitale që përmbajn revista akademike të cilat mund të aksesohen lirisht nga stafi dhe studentët. UAMD është gjithashtu pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online), një rrjet ku janë të përfshira të gjitha vendet e rajonit të Europës Juglindore. Si anëtare e Konsorciumit të Bibliotekave Akademike në Shqipëridhe përmes Projektit ERA2012 (Electronic Resources for Albania), lexuesit përfituan akses në një gamë të gjerë të burimeve elektronike me tekst të plotë. UAMD fitoi statusin “EU Info Point” me anë të si cilës në bibliotekën e UAMD-së mbërrijnë periodikisht publikime nga Zyra e Publikimeve të BE-së në Luksemburg. Njekohesisht, Biblioteka e UAMD është pjesë e ALASE – Albanian Academic Search Engine, aksesueshme nga https://ulibrary.rash.al (Ref. RVB, fq. 41; Aneks 128 – Dok. Manual Biblioteka Online; Aneks 129 – Dok. Biblioteka Online të dhëna mbi materialet e disponueshme; Vizita te institucioni).</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Çdo vit sipas kërkesave të stafit akademik, po përgatitet një listë të re blerjesh për të pasuruar fondin e Bibliotekës. Kërkesat për pasurimin e fondit të Bibliotekës vinë nga departamentet. Nga takimi që patëm me stafin akademik na u konfirmua fakti që institucioni i merr në konsiderat kërkesat e tyre për literaturë plotësuese (Ref. RVB, fq. 41; Aneks 50 – Dok. Rregullorja e Bibliotekës UAMD; Takimi me stafin akademik).</p>			
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj</p>	<p>Biblioteka qëndron e hapur nga e hëna në të premte dhe orari i funksionimit të Bibliotekës është 08.00-16.00. Shërbimi i informacionit elektronik mbetet i hapur nga e hëna në të diel 08.00-20.00. Oraret e shërbimit të bibliotekës janë përshtatur me oraret e programit të studimit dhe me nevojat e studentëve (Ref. RVB, fq. 41; Vizita te institucioni).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.

<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë</p>	<p>Ndryshuar pas vlerësimit të ekspertëve mbi informacionit e marrë (Shih Memo f.5)</p>



<p>informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Sistemi i UAMD në praktikë kryesisht është i bazuar në “letër”, pavarësisht faktit se ekziston sistem elektronik i quajtur Pitagora i cili synon ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të dhënave të studentit nga regjistrimi deri në diplomim. Gjithashtu, programi MPPP nuk posedon regjistrat e veta për gjeneralitetet dhe për arritjet akademike; të dhënat e studentëve ruhen në Excel, i cili nuk siguron sigurinë e të dhënave. UAMD përmban informacionin personal të studentit dhe e-mail adresat e tyre për informimin për aktivitete të ndryshme. Studentët po ashtu informohen nga faqe zyrtare e internetit të institucionit http://www.uamd.edu.al, rrjetet sociale, në mjediset publike të ndërtesave të universitetit, si dhe nga sistemi ‘Pitagora’. Faqe zyrtare e internetit të institucionit ka informata të limituar për programin MPPP. Menaxhimi dhe përditësimi të faqës zyrtare e internetit duhet të sinkronizohet me punën ditore të departamenteve. UAMD nuk u ofron studentëve e-maile me domainin e universitetit; studentët dhe në shumë raste stafi, përdorin adresat e tyre personale të postës elektronike (Ref. RVB, fq. 42; Takimet me anëtarët e GVB, stafi akademik, Dekani i FSHPJ/Përgjegjësi i DAP, Sekretaria mësimore dhe studentët).</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi i UAMD për ruajtjen e informacionit me lidhje të personelit është i bazuar në arshivimin e dokumentacionit në letër, e cila duket se funksionon në mënyrë efektive dhe efikase. Departamenti dhe zyra e burimeve njerëzore posedon dhe ruan informacione të tilla si CV-në e personelit dhe ngarkesat e tyre (Ref. RVB, fq. 42; Aneks 114 – Dok. Ngarkesat e personelit akademik me kohë të plotë të pjesshme dhe të ftuar për 2016-2020; Aneks 136 – Dok. Rregullorja për arshivimin; Aneks 138 – Dok. Praktike rekrutimi; Takimet me anëtarët e GVB dhe përfaqësues të Zyrës së burimeve njerëzore).</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi bazuar në letër i menaxhimit të dokumentacionit e nevojshem që përdoret të UAMD mundëson aksesin e dedikuar për stafin dhe studentët sipas programeve të studimit. Por, ky sistem nuk ofron akses të lehtë të informacionit dhe nuk e rritë transparencën e puna e institucionit siq është parashikuar të Programi i transparencës të institucionit (Ref. RVB, fq. 42; Aneks 66 – Dok. Manual për funksionimin e sekretarisë; takimet me anëtarët e GVB, studentët dhe stafi akademik).</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Shkëmbimi të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve bëhet përmes përdorimit të e-maileve të stafit që vihen në dispozicion të studentëve nga fillimi i vitit akademik. Përmes sistemit të integruar “Aula” është parashikuar që institucioni të mundëson komunikimin midis studentëve dhe stafit. Këto sisteme lehtësojnë komunikimin dhe shkëmbimin e materialeve dhe informacionit (Ref. RVB, fq. 42; Takimet me anëtarët e GVB dhe Sekretaria mësimore).</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të</p>	<p>Monitorimi i aktivitetit akademik e administrativ bëhet nga njësi bazë – Departamenti, që pastaj e raporton tek Zëvendës Dekani për mbarëvajtjen e procesit mësimor. Ky informacion në të njëjtën kohë është edhe një mjet në dispozicion të organeve drejtuese dhe titullarët,</p>

dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	për të monitoruar mbarëvajtjen e procesit akademik (Ref. RVB, fq. 42; Takimet me anëtarët e GVB dhe Dekani i FSHPJ/Përgjegjësi i DAP).			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	Në faqen e internetit të UAMD gjendet vetëm informacion për kurrikulën e programit të studimit MPPP. Faqja në internet është kryesisht në gjuhën shqipe; mungon informacion në anglisht (Ref. RVB, fq. 42; Takimet me anëtarët e GVB dhe Dekani i FSHPJ/Përgjegjësi i DAP; vizitë në faqen e internetit të institucionit).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		
Standardi IV.6				
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Buxhetimi financiar në nivel institucional hartohen çdo vit. Raportet financiare hartohen në bazë institucioni dhe janë të ndara sipas programeve në cikle dhe specifike për programet e studimit. Sipas raporteve financiare të institucionit, kostot e programit të studimit MPPP janë 1,332,992 LEK (rreth 11,000 euro) në vit (Ref. RVB, fq. 43; Aneks 81 – Dok. Tabelat për kostot e programit të studimit).			
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtje e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.	Plani i financimit hartohet në nivel institucional dhe përmban elemente financiare në bazë programi (Ref. RVB, fq. 43; Aneks 119 – Dok. Veprimtaria financiar dhe Analize kosto).			
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	Institucioni kryen auditim të nga njësitë e auditimit të brendshëm. Institucioni ka raporte auditimi të brendshëm çdo vit. Nuk ka informacion nëse dhe cila kompani e auditimit të jashtëm kryen auditimin e jashtëm të UAMDnë përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (Ref. RVB, fq. 43; Aneks 15 – Dok. Raport 5 Vjearar Veprimtaria Auditit).			

<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Plani i financimit hartohet në nivel institucionit dhe përmban elemente financiare për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të programit (Ref. RVB, fq. 43).</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	<p>Fakti që programi i studimit është organizuar nga Departamenti Administrim Publik qëmenaxhon disa programe të studimit në bashkëpunim me departamente dhe fakultete të tjera lehtëson funksionimin financiar të programit (Ref. RVB, fq. 43; Takimet me Dekani i FSHPJ/Përgjegjësi i DAP).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1				
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	UAMD realizon pranime në përputhje me ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimin e Senatit Akademik. Informacioni për procedurën e aplikimit janë të hartuara te statuti i UAMD, dhe te rregulloret e fakultetit FSHPJ, departamentit DAP dhe të programit të studimit MPPP. Mungon informata specifike online për programe studimit. Institucioni kujdeset që të ndjekë ecurinë e studentit gjatë gjithë procesit (Ref. RVB, fq. 44; Aneks 1 - Dok. Statuti UAMD; Aneks 19 – Dok. Rregullore e FSHPJ; Aneks 23 – Dok. Rregullore e programit MPPP; Faqa zyrtare e universitetit).			
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Në bazë të dokumentacionit të shqyruar rezultojnë se politikat dhe procedurat e ndjekura përpara pranimit dhe përfundimit të studimeve janë të njëjta për të gjithë studentët (Ref. RVB, fq. 44).			
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Studentët kanë mundësi që të aksesojnë këto kriteret dhe procedura nga dokumentacioni te Sekretaria mësimore. Por këto informacione nuk janë lehtësisht të arritshme dhe të aksesueshme përmes internetit (Ref. RVB, fq. 44-45; Faqa zyrtare e institucionit).			
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	Përmes vendimeve të Senatit Akademik të UAMD institucioni vendos për kriteret shtesë krahas atyre të përcaktuara nga Udhëzimi i Ministrisë. Keta vendime janë publike, por ka mungesë të aksesit të lehtë në to përmes faqes zyrtare të institucionit. Të gjithë kriteret, si të përgjithshme edhe të veçanta, duhet publikohen në faqen e UAMD (Ref. RVB, fq. 45).			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	Institucioni ka disa forma të informimit dhe orientimit mbi kërkesat e kriteret që ka programi i studimit si: takimet informuese në institucion; përdorimi i faqes zyrtare; rrjeteve sociale etj. (Ref. RVB, fq. 45).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Përmes dokumentacionit përkatës institucioni mundëson një informacion dhe njohjen e përparimeve akademike nga studentët në kohë reale. Gjithashtu, krahas sekretarisë mësimore është dhe koordinatori i programeve master professional të Departamentit i cili bënë të mundur dhënien e informacionit. Studentët informohen në lidhje me kurset e detyrueshme dhe me zgjedhje, praktikën profesionale dhe temën e diplomës si edhe me numrin e krediteve (ECTS) që marrin për çdo lëndë (Ref. RVB, fq. 45; Aneks 2 – Dok. Rregullore UAMD; Aneks 19 – Dok. Rregullore FSHPJ; Aneks 23 – Dok. Rregullore e programit MPPP; Aneks 27 – Dok. Kurrikulat2018; Takimi me stafin akademik).
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.	Institucioni ka hartuar procedura mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin ku bazohet realizimi i procedurës dhe informimi i studentëve mbi këto procese. Zyra e Sekretarisë Mësimore, në bashkëpunim me Departamentin, informojnë studentët dhe bëjnë vlerësimet paraprake për studentët e interesuar për të transferuar studimet (Ref. RVB, fq. 45-46; Aneks 2 – Dok. Rregullore UAMD; Aneks 19 – Dok. Rregullore FSHPJ; Aneks 23 – Dok. Rregullore e programit MPPP).
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Studentët në fillim të çdo semestri informohen nga stafi akademik mbi procedurat e vlerësimit të dijeve. Kriteret dhe procedurat e vlerësimit parashikohen në Syllabuset të lëndëve, të cilat i vihen në dispozicion dhe i shpjegohen studentëve që në fillim të procesit akademik. Kriteret dhe procedurat janë hartuar dhe percaktuar te Rregulloret e institucionit dhe programit MPPP. Por rregulloret dhe syllabuset nuk janë të aksesueshme lehtësisht - online - nga studentët (Ref. RVB, fq. 46; Aneks 2 – Dok. Rregullore UAMD; Aneks 19 – Dok. Rregullore FSHPJ; Aneks 23 – Dok. Rregullore e programit MPPP; Aneks 107 – Dok. Syllabuse MPPP 2019 - 2020; Takimi me stafin akademik; vizitë në faqen zyrtare të institucionit).
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Ndryshuar mbas komenteve të UAMD,DAP (Memo f.5). Institucioni organizon seanca informimi mbi punimin e diplomës. Studentët edhe përmes e-mailit janë udhëzuar mbi literaturën dhe formatin e testimit. Fazat kohore të dorëzimit dhe mbrojtjes së diplomës bëhen të ditura te Kalendari Akademik. Departamenti përgatit paketë udhëzuese për përgatitjen e punimit të diplomës. Vërehet mungesa e Syllabusi për lëndën “Përgatitje e mikrotezës” që do të percaktoje më konkretisht dhe në detaje fazat e përgatitjes, formatin, dhe numrin e faqeve/fjalëve për punimin e diplomës, etj. (Ref. RVB, fq. 46; Aneks 2 – Dok. Rregullore UAMD; Aneks 19 – Dok. Rregullore FSHPJ; Aneks 23 – Dok.

	Rregullore e programit MPPP; Aneks 47 – Dok. Procedure Diplomimi DAP; Aneks 68 – Dok. paketa e udhëzimeve e praktikës dhe mikrotezëz shembull; Aneks 107 – Dok. Syllabuse MPPP 2019 - 2020; Takimi me stafin akademik).			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Institucioni ka disa forma për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit MPPP si takimet e Departamentit për studentët e interesuar, materialet informuese, faqja zyrtare e institucionit, etj. (Ref. RVB, fq. 46; Takim me stafin akademik).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Ky lloj informacioni ofrohet nga Departamenti Administrim Publik si njësia bazë që nga momenti që studenti fillon me studimet. Institucioni ka edhe disa forma të tjera informimit; online ose përmes sekretarisë mësimore, dhe në kontaktet e përditshme e studentëve me stafin akademik. Këto struktura mundësojnë informacion në lidhje me strukturën dhe organizimin e programit të studimit MPPP. Ëëb-faqja e institucionit nuk ka informacion të detajuar për programin MPPP, përveç planit mësimorë. Programi është organizuar në dy semestra, me lëndë të detyrueshme dhe me zgjedhje të vlerësuara në kredite (ECTS). Gjuha e mësimdhënies është Shqip. Numri i krediteve të nevojshme për të përfunduar studimet është 60 ECTS, që i korespondon 2 semestrave studimor. Edhe nga takimi me studentet u vu re se ato ishin të mirë informuar mbi afatin e përfundimit të studimeve si dhe organizimin e programit të tyre (Ref. RVB, fq. 47; takimet me stafin akademik dhe studentët).
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Institucioni siguron informacion për studentët në lidhje me elementët e programit të studimit. Plani mësimorë përmban informata për lëndë që studentët duhet të ndjekin gjatë studimit. Info për studentët ofrohet edhe online në faqen e internetit ku gjendet informacion në lidhje me planin mësimorë e programit të studimit MPPP. Syllabuset janë të përditësuar dhe të hartuar çdo vit, por nuk janë të aksesueshme lehtë – online - nga studentët (Ref. RVB, fq. 47; Aneks 24 – Dok. Planet mesimore master professional 2018; Faqja zyrtare e institucionit; Takimet me stafin akademik dhe studentët).

Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Institucioni ka disa struktura që adresojnë vënien në kontakt të studentëve me mundësitë e punësimit. Konkretisht, Zyra e Këshillimit dhe Karrierës informon dhe bënë njoftime për mundësi punësimi. Vërehet mungesa e mbështetjes active institucionale për orientimin drejt tregut të punës. Aktivitetet në këtë drejtim janë të kufizuara (Ref. RVB, fq. 47; Aneks 41 – Dok. Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrieres; Takimet me stafin akademik dhe studentët).			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Stafi akademik i programit MPPP mban kontakte të rregullta përmes postës elektronike me studentët që ndjekin programin e studimit në lidhje me procesin mësimor, kalendarin akademik dhe aktivitete të ndryshme mësimore që organizohen në UAMD (Ref. RVB, fq. 47; Aneks 42 – Dok. Strategjia e Komunikimit UAMD; Takimet me stafin akademik dhe studentët).			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë	Sistemi ekzistues bazuar në kontaktet e studentit drejtpërdrejt me Sekretarinë Mësimore, Departamentin dhe stafin akademik mundëson komunikimin midis studentëve dhe institucionit për çdo informacion që lidhet me organizimin e programit mësimor. Gjithë informacioni, dokumentacioni dhe rekordet e studentit, që nga fillimi i studimeve deri në përfundim të programit e studimit ruhen në Sekretarinë Mësimore. Megjithatë, informacioni dhe dokumentacioni për studentet e programit të studimit MPP nuk mirëmbahen në regjistra dedikuar për programin e studimit por ato ruhen në një dokument të Excel-it, i cili nuk siguron sigurinë e të dhënave (Ref. RVB, fq. 47; Takim me Sekretarinë Mësimore).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishe në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	Institucioni disponon të dhëna të tilla. Në vizitën e realizuar në institucion dhe takimin me Sekretarinë Mësimore, GVJ iu vu në dispozicion të dhëna që lidheshin me numrin e studentëve të regjistruar dhe të diplomuar në programin e studimit. Por institucioni nuk mban statistika të sistematizuar për studentët aktivë dhe të diplomuar nga programi MPPP. Numri i studentëve të diplomuar të programi MPPP deri tani është 6 (Ref. RVB, fq. 47-48; Dok. minutat e takimeve në IAL; Aneks 82 – Dok. Tabele e sekretarisë mësimore për numrin e studentëve për programin e studimit; Takim me Sekretarinë Mësimore).
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e	Institucioni disponon statistika të tilla. Që nga fillimi i programit në vitin akademik 2018-2019, 34 studentë janë të regjistruar te

studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	programi MPPP. 3 studentë janë tërhequr. Studentë aktual janë 25. Studentë të diplomuar janë 6. Nga takimet që GVJ pati te institucioni, u vu re se vetëm Sekretaria mësimore e dinte numrin e saktë të studentëve të programi MPPP. Ekziston nevoja që statistika të sakta të komunikohen ndërmjet zyrave (Ref. RVB, fq. 48; Takimet me Sekretarinë Mësimore dhe zyra të ndryshme të institucionit).			
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	Institucioni disponon për çdo student dosjen me të gjitha të dhënat që nga momenti i regjistrimit e deri pas diplomimit. Gjeneralitetet e studentit, së bashku me arritjet akademike, ruhen në sistemin elektronik – Excel, por jo në regjistrat për gjeneralitetet dhe arritjet akademike që plotësohen me shkrim (Ref. RVB, fq. 48; Takimi me Sekretarinë Mësimore).			
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Universiteti ruan, administron dhe përpunon të dhënat e studentëve, atyre akademike, dhe prodhimin e raporteve statistikore, etj. Përmbajtja e informacioneve të statistikave nuk menaxhohet përmes ndonjë sistemi informatik dhe të sigurtë (Ref. RVB, fq. 48-49; Takimi me Sekretarinë Mësimore).			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	Njësia bazë – Departamenti Administrim Publik, Sekretaria Mësimore dhe Zyra e këshillimit dhe të Karrierës harton raporte analitike mbi ecurinë e programit, por mungon raporte analitike për cilësinë në hyrje, dalje dhe shkallën e punësimit, pasi ata e lehtëson vlerësimin dhe promovimin e programit (Ref. RVB, fq. 49; Aneks 9 – Dok. Analiza vjetore DAP 2019; Takimet te institucioni).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Bazuar në statutin dhe rregulloret e universitetit studentët përfshihen në disa struktura si: Senati Akademik; Këshillat studentore; Komisionin e sigurimit të cilësisë; Komisione ad hoc, etj. Studentët gjithashtu angazhohen për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies nëpërmjet anketimeve (Ref. RVB, fq. 49-50; Aneks 1 – Dok. Statuti UAMD; Aneks 2 - Dok. Rregullore UAMD; Aneks 19 – Dok. Rregullore e FSHPJ; Aneks 46 – Dok. Rregullore e DAP; Aneks 23 – Dok. Rregullore e programit MPPP).
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në	Angazhimi i studentëve është konkrete pasi ata janë vendimmarrës në disa struktura të universitetit. Të dhënat e mbledhura nga vlerësimet e studentëve për cilësinë e mësimdhënies përmes Njesisë e Sigurimit të




<p>vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Cilesisë, bëhen pjesë e diskutimeve në nivel drejtues të institucionit, me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e situatës. Rezultatet e këtyre instrumentave trajtohen në nivel të strukturave drejtuese. Rekomandohet të bëhen analiza periodike mbi përfshirjen e të studentëve në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik (Ref. RVB, fq. 50; Takimet te institucioni).</p>			
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Nga shqyrtimi i planit mësimor të programit MPPP është vërejtur një ndarje e balancuar dhe barabartë e ngarkesës mësimore në të 2 semestrat (30 ECTS për semestër). Semestri i dytë dhe të fundit, përveç dy lëndëve të detyrueshme dhe një lëndë me zgjedhje, dedikohet praktikës profesionale dhe punimit të diplomës, në mënyrë që studentët të kenë kohën e nevojshme për t'iu përkushtuar përfundimin e studimeve. Kurrikula përmban lëndë bashkëkohore të nevojshme për këtë lloj program. Rregulloret e programit parashikon njohjen e studimeve të kryera më parë (Ref. RVB, fq. 50-51; Aneks 2 – Dok. Rregullore UAMD; Takimet te institucioni).</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Njesia bazë – DAP, organizon takime në formatin e hapur për studentët. Ata shërbejnë si instrumente për të matur perceptimin e studentëve në lidhje me programin. Në takimin me studentët, shprehen kënaqësinë e tyre nga puna e Departamentit dhe të stafit menaxherial dhe akademik në organizimin e takimeve të hapura për studentët e programit (Ref. RVB, fq. 51; takimi me studentët).</p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Rregulloret e Universitetit përcaktojnë procedura në rast ankese nga studenti. Studenti realizon ankesën pas shpjegimeve përkatëse gjatë seancës sqaruese me pedagogun e lëndës. Studenti mund t'i drejtojë te Dekani i Fakultetit – FSHPJ - një kërkesë me shkrim, për rivlerësimin e provimit. Studentët gjithashtu kanë mundësi të shprehin mendimin, vlerësimin dhe kërkesat e tyre duke plotësuar pyetësorin (gjithsej 5 pyetësorë për semestër: për pedagogun, lëndën, administratën, etj.), i cili realizohet në fund të çdo semestri (Ref. RVB, fq. 51-52; Dok. minutat e takimeve në IAL; Aneks 134 – Dok. Analiza pyetësorëve; takimet me studentët, stafi akademik dhe Dekani i FSHPJ/Përgjegjësi i DAP).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Standardi V.6 Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në</p>	<p>Njësia Kryesore – FSHPJ ka Sekretarinë Mësimore e cila realizon informimin, mbështetjen dhe ndjekjen e studentit gjatë vijimit të</p>

shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	studimeve. Gjithashtu, Departamenti dhe stafi menaxherial dhe akademik ndihmojnë studentët në zhvillimin e tyre personal, shoqëror dhe akademik, duke bërë të mundur një eksperiencë të studiuar sa më të mirë (Ref. RVB, fq. 52; Takimi me studentët).			
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. .	Ky sistem i përbërë nga Sekretaria Mësimorë dhe Departamenti, dhe gjithashtu nga Zyra e Komunikimit, Alumnit, dhe Karrierës, shërbejnë si burime primare të informacionit dhe këshillimit rreth mundësive të studimit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomim. Njëkohësisht, ekziston sistemi i “mentorimit” të studentëve nga stafi akademik që ka për qëllim mbështetjen e studentëve në procesin mësimor (Ref. RVB, fq. 52-53; Aneks 98 – Dok. Vendimi i mentorimeve dhe grafiku).			
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Në nivel universiteti funksionon “Zyra e Komunikimit, Alumnit, dhe Karrierës”. Kjo zyrë e zhvillon aktivitetin e saj në shërbim të informimit e këshillimit të karrierës. Studentët e interesuar kanë mundësi të marrin shërbim për këshillimin e karrierës dhe praktikës profesionale. Vërehet mungesa e aktiviteteve të ndryshme institucionale si veprimtaripër lidhjen e studentëve me tregun e punës (Ref. RVB, fq. 53; Aneks 41 - Dok. Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës).			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse	Institucioni nëpërmjet Zyrës së Komunikimit, Alumnit, dhe Karrierës disponon të dhëna të tilla. Zyra në detyrat e saj ka gjurmimin e studentëve pas diplomimit dhe përpunon statistika mbi Alumnin. Është themeluar Bordi për Alumnin (Ref. RVB, fq. 54; Dok. minutat e takimeve në IAL).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	




VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Bazuar në Statutin e UAMD janë të përcaktuara strukturat dhe procedurat për realizimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Struktura që realizon këtë proces në nivel institucional është Drejtoria e Kurrikulave dhe Standarteve të Cilësisë (DKSC), ku edhe njësia bazë – DAP ka një përfaqësues. Roli i DKSC-së, e cila përbëhet nga 9 anëtarë, është të zhvillojë politikën, strategjitë, proceset dhe udhëzimet, në funksion të rritjes së cilësisë në UAMD. Struktura tjera e rëndësishme në sigurimin e brendshëm të cilësisë janë edhe Zyra për Sigurimin e Cilësisë dhe Vlerësimin Institucional, e cila funksionon brenda DKSC-së dhe Komisioni i Përherëshëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (Ref. RVB, fq. 54; Dok. minutat e takimeve në IAL; Aneks 1 - Dok. Statuti UAMD; Aneks 8 - Dok. Rregullore e sistemit të brendshëm të cilësisë UAMD).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>DKSC ka për detyrë vlerësimin periodik të veprimtarisë mësimore e kërkimore. Institucioni angazhon edhe studentët për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë me anë të pyetësorëve të hartuar në fund të çdo semestri. DKSC gjithashtu angazhon dhe ekspertë të jashtëm pranë DKSC-së. Institucioni ka një strategji për përmirësim konstant të cilësisë si pjesë e planit strategjik të institucionit (Ref. RVB, fq. 54-55; Aneks 6 - Dok. Plani strategjik 2016-2020 i zhvillimit UAMD).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Institucioni përdor strukturat brenda tij për realizimin e sigurimit të cilësisë. Institucioni gjithashtu i është nënshtruar akreditimit institucional dhe akreditimit të programeve të studimit nga autoritetet kombëtare. Në akreditimin institucional në vitin 2016, UAMD u vlerësua me një akreditim për 5 vite akademike (Ref. RVB, fq. 55-56; Aneks 142 – Dok. Certifikata e Akreditimit; Takimet të institucionit).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e sistemit të mbrendshëm të cilësisë UAMD struktura përgjegjëse DKSC programon punën dhe ndjek procedura periodike. Rezultatet e marra nga monitorimi, analizat dhe raportet vihen në dispozicion të strukturave drejtuese në nivel të njësive bazë, kryesore dhe institucionale (Ref. RVB, fq. 56; Aneks 8 – Dok. Rregullore e sistemit të mbrendshëm të cilësisë UAMD; Takimet të institucionit).</p>

cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.	Në nivel institucional struktura përgjegjëse për monitorimin e cilësisë është DKSC-ja, brenda së cilës është edhe Zyra për Sigurimin e Cilësisë dhe Vlerësimin Institucional, dhe Komisioni i Përherëshëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Në nivel njësie bazë është Departamenti së bashku me strukturat e tij të brendshme si përgjegjësi i departamentit dhe koordinatori i programit (Ref. RVB, fq. 57; Takimet te institucioni).
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	Institucioni përmes DKSC-së realizon procese dhe mekanizma vlerësimi periodike mbi elementë të ndryshëm të programeve të studimit në nivel Universiteti. Raportet që rezultojn nga këto mekanizma janë pjesë e diskutimeve në nivel Rektorati sikurse dhe në nivel fakulteteti dhe departamenti (Ref. RVB, fq. 57-58; Aneks 30 – Dok. Raporti i vlerësimin të brendshëm të cilësisë FSHPJ; Takimet te institucioni).
Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	Zyra Mesimore si pjesë e DKSC realizon aktivitetet me karakter monitorues për vlerësimin në nivel institucional të të gjitha programeve të studimit. Sistemi i instaluar (anketimi i studentëve) dhe funksionimi i DKSC-sëme struktura të lidhura janë tregues të metodologjisë së vlerësimin. Përdoren edhe metoda të drejtpërdrejta si dëgjime në auditor nga Departamenti dhe Fakulteti (Ref. RVB, fq. 58; Takimet te institucioni).
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Raportet e realizuara nga DKSC-ja dhe nga struktura të ndërlidhura janë në dispozicion të strukturave drejtuese dhe stafit. Rezultatet e vlerësimin të cilësisë së programeve të studimit përpilohen në formë dokumenti dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse (Ref. RVB, fq. 58; Takimet te institucioni).
Kriteri 5. Raportet e vlerësimin duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimin dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	Raportet e vlerësimin përfshijnë tregues kyç të performancës (TKP) për të analizuar kontributin e punës në arritjen e objektivave strategjike institucionale. Trajtimi i rezultateve të vlerësimin në institucion bëhet në disa nivele. Monitorimi i procesit të përmbushjes së masave në kuadër të mangësive të konstatuara realizohet nga DKSC, por edhe nga Fakulteti dhe Departamenti (Ref. RVB, fq. 58-59; Takimet te institucioni).

Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	DKSC-ja realizon vlerësim në nivel institucional tek të gjitha programet e studimit. Relacione specifike në bazë programave harton njësia kryesore - FSHPJ dhe njësia bazë- DAP. Ata realizojnë analiza të përgjithsme dhe specifike për programin MPPP dhe për programe tjera që ata ofrojnë. Këto raporte vetvlerësimi nga ana e departamenteve shqyrtohen nga DKSC-ja për realizimin e vlerësimin të përgjithshëm (Ref. RVB, fq. 59; Takimet te institucioni).
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimin, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	Institucioni përdor disa instrumeta për realizimin e procesit të vlerësimin si raporte vjetore institucionale të cilat përmbledhin analizen e procesit mësimor dhe atë shkencorë dhe vlerësimet periodike nga Dekani dhe Përgjegjësi i Departamentit (Ref. RVB, fq. 59; Aneks 16 – Dok. Raporti vjetor 2018-2019; Aneks 45 – Dok. Kërkimi shkencor; Takimet me Dekanin dhe Përgjegjësin e Departamentit, dhe anëtarët e GVB).
Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimin të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Institucioni monitoron mësimdhënien, provimet, silabuset, literatura e përdorur, etj. Realizohen monitorime edhe nga ana e eprorëve. Gjithashtu vlerësimi që japin studentët për procesin mësimor dhe sistemi i Mentorimit janë instrumente të tjerë (Ref. RVB, fq. 59; Takimet te institucioni).
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimin të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar	Institucioni përmes DKSC kryen sondazhe periodike me studentët. Sondazhet janë me të gjithë studentët, për të gjitha lëndët dhe të gjithë pedagogët. Gjithashtu, DKSC realizon takime me stafin dhe studentët. Rezultatet e tyre i vë në dispozicion të drejtuesve të institucionit dhe reflektohen në vlerësimin e performancës së programit të studimit. CleanScore i mbështetur nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan

(alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	zbatohet në UAMD me synim rritjen e transparencës nëpërmjet korigjimit të automatizuar të testimeve(Ref. RVB, fq. 59-60; Aneks 110 - Dok. Anketimi i studenteve nga dega mësimore; Takimet të institucioni).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Studentët dhe ekspertët të jashtëm janë përfshirë të strukturat e UAMD për sigurimin e cilësisë. Studentët dhe ekspert të jashtëm kanë qenë pjesë e aktiviteteve me fokus sigurimin e cilësisë. Projekti CleanScore i mbështetur nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan realizoi përpunimin e pyetësorëve për vlerësimin nga studentët për mbi 420 pedagogët e universitetit (Ref. RVB, fq. 60; Aneks 2 – Dok. Rregullore UAMD; Takimet të institucioni).
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Përgjegjësitë dhe detyrat e njëjësive të angazhuara janë të përcaktuara në kuadrin ligjor mbi të cilin funksionon UAMD dhe të dokumentet institucional që rregullojnë veprimtarinë e lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë. Sekretaria mësimore ruan evidencën e pjesëmarrjes së pedagogëve në klasë. Është shumë domethënëse që ekziston qëndrueshmëria në kontratat e punës të pedagogëve, si dhe në alokimet e mësimdhënies (Ref. RVB, fq. 60; Aneks 2 - Dok. Rregullore UAMD; Aneks 19 – Dok. Rregullore FSHPJ; Aneks 46 – Dok. Rregullore e Departamentit Administrim Publik; Aneks 23 – Dok. Rregullore e programit MPPP; Takimet të institucioni).
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.	Komisioni i Përhereshëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë dhe struktura të tjera për sigurimin e cilësisë përbëhen nga stafi akademik, personeli ndihmës akademik, stafi administrativ, studentët, dhe ekspert i jashtëm (RVB – fq. 60-61).
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimin duhet	Ka disa standarte të cilat respektohen për përzgjedhjen e anëtarëve të strukturave për sigurimin e cilësisë. Ata, ndër të tjerat, nuk duhet të jenë pjesë e autoriteteve drejtuese të universitetit dhe të kenë

të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	kualifikimet e nevojshme profesionale. Institucioni ka miratuar rregullore për studentët me aftësi të kufizuara (RVB – fq. 61; Aneks 55 – Dok. Rregullore për studentët me aftësi të kufizuara; Takimet te institucioni).			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	Institucioni angazhon ekspertë të jashtëm në strukturat e tij për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Gjithashtu, pjesëmarrja në aktivitete të lidhura me sigurimin e brendshëm të cilësisë janë tregues të angazhimit të aktorëve të jashtëm në proceset e brendshëm të cilësisë (RVB – fq. 61; Takimet te institucioni).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë të UAMD funksionon në bazë të dokumenteve dhe rregullave institucionale, të cilët përcaktojnë politikat dhe organizimin e veprimtarisë në kuadër të sistemit të brendshëm të cilësisë. Disa, por jo të gjitha, nga këto dokumenta janë transparente dhe të aksesueshme publike (RVB – fq. 61; Takimet te institucioni).
Kriteri 2. Institucioni i arsimi të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Vlerësimi është në nivel institucional, dhe rezultatet e tij sipas rregullave duhet të bëhen publike dhe transparente. Por, rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit nuk publikohen. Sygjerohet një përmbledhje e rezultateve dhe masave propozuese, të jenë publike dhe të aksesueshme për studentët dhe më gjerë (RVB – fq. 62; Aneks 13 – Dok. Programi i Transparencës së UAMD; Takimet te institucioni).
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Institucioni realizon një proces vijueshmërie të rezultateve dhe masave që duhet të ndërmerren si rezultat eraporteve të vlerësimit. Vlerësimet pasqyrohen te raportet vjetore të departamentit, fakultetit dhe universitetit. Rezultatet shfrytëzohen në mbështetje të procesit të procesit vijueshmërisë në vlerësimin e performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të semestrit ose vitit akademik (RVB – fq. 62; Aneks 16 – Dok. Raporti vjetor 2018-2019; Aneks 30 – Dok. Raporti i vlerësimit të brendshëm të cilësisë FSHPJ; Aneks 9 – Dok. Analiza vjetore DAP 2019; Takimet te institucioni).
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër	Departamenti reflekton nga rezultatet e vlerësimit dhe trajton masat që lidhen me programet e studimit që ai mbulon. Në bazë të natyrës së

të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	problematikave të evidentuara nëpërmjet pyetësorëve, janë marrë masa dhe aktiviteteve konkrete për problemet dhe sfidat të cilët mund të kenë shfaqur problematikë të vazhdueshme për programin e studimit (Ref. RVB, fq. 62; Takimet te institucioni).			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	Njësia kryesore Fakulteti dhe njësia bazë Departamenti realizon aktivitete dhe veprimtari siç janë takimet të hapura me studentët që mundeson informimin dhe ndërgjegjësimin e stafit akademik ashtu edhe studentët për sigurimin e cilësisë (Ref. RVB, fq. 62-63; Takimet te institucioni).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional “Politika Publike” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti ‘Aleksandër Moisiu’ Durrës - UAMD”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Kurrikula e programit të studimit fokusohet në çështje specifike dhe bashkëkohore në fushën e politikave publike.
2. Programi i studimit është në harmoni me interesat kombëtare pasi një programi i tillë ka një rol të rëndësishëm në arritjet e interesave kombëtare siç janë përgatitja e vendit për integrim në BE, dhe pajisja e vendit me njerëz të përgatitur në fushën e qeverisjes të mirë dhe administratë publike efektive.
3. Kushtet infrastrukturore në kampusin e ri të universitetit, si dhe personeli menaxherial, akademik dhe administrativ në sasi dhe cilësi përbëjnë pikat e forta të programit studimit MPPP.


Pika të dobta

1. Programi MPPP nuk posedon regjistrat e veta për gjeneralitetet dhe për arritjet akademike të studentëve; të dhënat e studentëve rruhen në Excel, i cili nuk siguron sigurinë e të dhënave.
2. Vërehet mungesa e kulturës për transparencë më të madhe në punën e universitetit, fakultetit dhe departamentit.
3. Mungon praktika konkrete të bashkëpunimit me administratën publike në funksion të realizimit të objektivave të programit të studimit.
4. Numri i kufizuar i veprimtaritë dhe aktiviteve ku studentët do të përfshihen në organizimin e tyre si dhe në pjesëmarrjen aktive në to.
5. Vërejmë se projektet dhe grupet hulumtuese kanë pak lidhje me programin e studimit.

Rekomandime

1. Rekomandohet që programi të ketë regjistrat e tij sa më shpejt që të jetë e mundur.
2. Për një mbarëvajtje sa më të mirë të programit të studimit dhe për të siguruar një harmoni programit të studimit me publikun më të gjerë, është e nevojshme intensifikimi i përpjekjeve të institucionit në drejtim të sigurimit të më shumë informacionit publik në faqen e internetit. Dokumentet dhe informacionet publike e institucionit dhe të programit të studimit, duhet të jenë aksesueshme edhe për publikun më të gjerë në faqen zyrtare të universitetit në internet në përputhje me Programin e Transparencës së institucionit.
3. Specifikisht për programin e studimit MPPP, për një harmonizim më të mirë me politikat publike aktuale në Shqipëri, sugjerohet vendosjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit të mëtejshëm dhe më gjithëpërfshirës me institucionet e administratës publike në nivelin qendror dhe lokal si dhe me rregullatorët e pavarur të shtetit.

4. Këshillohet hartimi i një planit vjetor të veprimtarisë nga Departamenti Administrim Publik që do të përfshijë aktivitete dhe që do të synojnë nevojat e studentëve të programit të studimit dhe përfshirja e studentëve dhe strukturave të tyre në organizimin e aktiviteteve.
5. Sugjerohet fillimi i një projekti ose grupi hulumtues me financim nga institucioni në fushën e 'politikave publike' që mund të kontribuojë në përfshirjen e pedagogëve dhe studentëve të programit të studimit dhe përfaqësuesit e administratës publike. Gjithashtu, me vlerë do të ishte që institucioni të fillojë me zbatimin e vendimit të mbështetjesfinanciare të stafit akademik për pjesëmarrje në konferenca dhe aktivitete shkencore.
6. Zgjerimi i sallës së Bibliotekës dhe përdorimi i saj nga studentët si sallë studimi.



to ley 55

Conclusions on the evaluation of the program of the second cycle of studies Profesional Master “Public Policies” of the Institution of High Education “University Aleksandër Moisiu, Durrës-UAMD”

Strengths:

1. The curricula focuses on the study of specific and contemporary cases of public policy analysis.
2. The study program is in harmony with the national interests considering that the subject has an important role on the accomplishment of national objectives such as the EU integration and the equipement of country with persons well prepared in the matter of good governance and an effective public administration.
3. The infrastructure offerd by the University in the new campus, as well as the quality of the academic and administrative body are one of the strong points of the study program of PMPP.

Weaknesses



1. The program in PMPP is not equipped with registers which contain the generalities as well as the scholarly achievements of the students; the database is conserved in the Excel format who does not guarantees the safety of the data.
2. There is an absence of transparency in the activity of the university, the faculty and the department.
3. There is an absence of concretet collaboration with the public administration in the achievement of the objectives of the said study program.
4. There is a small number of activities in which the students are involved as well as in the organization of said activities by the students themselves.
5. We observe that the project and the research grups have limited interaction with the study program.

Recommendations

1. It is recommended the program to have its own registers as soon as possible.
2. For a better progress of the study program and to ensure a harmony of the study program with the wider public, it is necessary to intensify the efforts of the institution in terms of providing more public information on its website. The documents and public information of the institution and of the study program should be accessible to the general public on the official website of the university in accordance with the Transparency Program of the institution.
3. Specifically for the MPPP study program, for a better harmonization with the actual public policies in Albania, it is suggested to establish further and more comprehensive

cooperation agreements with public administration institutions at the central and local level as well as with independent regulatory authorities.

4. It is recommended to draft an annual activity plan of the Department of Public Administration that will include activities that will target the needs of students of the study program and the involvement of students and the student structures in the organization of these activities.
5. It is suggested to start a research project or research group with funding from the university in the field of 'public policy' that can contribute to the involvement of professors and students of the study program and representatives of the state administration. It would also be worthwhile for the university to start implementing the decision for financial support of the academic staff for participation in conferences and scientific activities.
6. Expansion of the Library hall and its use by students as a study hall.



57

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE			X	
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR			X	

